

KALLEZIM PENAL

DREJTUAR: Z.Arben KRAJA, Drejtues i Struktures se Posacme Kunder Korrupsionit dhe Krimet te Organizuar.

KALLEZUES: Av. Romeo KARA, ekspert Ligjor i OSHEE-se (Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike), i biri i Dhimitrit dhe i Ilirijes, i lindur me 15.07.1967 ne Tirane dhe banues ne tirane ne adresen: Rruga Sulejman Delvina, p.!!/1, shk.2/7, dhe mbajtes I kartes se identitetit me numer: G70715195L.

I KALLEZUAR: Lazer SALLAKU, gjyqtar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, Dhoma Penale;

SHKAQET E ANKIMIT: Cenim te sigurise juridike, shperdorim i detyres duke rrezuar padrejtesisht kerkesen per konstatim te kompetences, cilesim i qellimshem dhe i manget juridik i veprave penale, moskonstatim i qellimshem te veprave te shumta penale, mungese e qellimshme e plote hetimi, moskontatim i qellimshem i kompetences, si dhe pushim i padrejte dhe i pambeshtetur ne ligj i ceshtjes me numer 7340/2017 dhe me objekt: Privatizimin e 76% te aksioneve te OSSH-se (Operatorit te Sistemit te Shperndarjes sh.a) nga ana e kompanise CEZ-Group.

KERKOHET: sekuestrimi i te gjitha dosjes se ceshtjes 7340/2017, hetimi i saj dhe i procedures se ndjekur deri me tani, si dhe i vendimit te pushimit me numer 5410/211 i dates 24.01.2020, ora 15:33 dhe date rregjistrimi 10.12.2019.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Shqiperise, Kodi Penal dhe Kodi i Procedures Penale te Republikes se Shqiperise.

Rrethanat e faktit

Kapitulli I

Hyrje

I nderuar z.Kraja,

- 1. Procesi i privatizimit te OSSH-se, zyrtarisht i filluar ne vitin 2008, ka qene i parapergatitur dhe fituesi i paracaktuar.**

1.01 Pergjate kryerjes se detyres sime si ekspert ligjor i OSHEE-se, une kam konstatuar fakte e prova, qe me shtyne te mendoj se, procesi i privatizimit te OSSH-se ne vitet 2008-9, ka qene me fitues

te parapergatitur, jo transparent, i nxituar, me mjaft shkelje ligjore si dhe me kryesorja: me pasoja shume te renda lidhur me ekonomine e vendit.

- 1.02 Persa me siper, une realizova nje investigim te plote te kesaj procedure, duke evidentuar nje sere problemesh, te cilat i permbloodha ne nje material disi konciz dhe i pergatita ne formen e nje kallezimi penal, te cilin ia dergova fillimisht, ne 31.03.2017, Prokurorise se Pergjithshme.
- 1.03 Prane kesaj prokurorie une jam paraqitur mbi 10 here, nga disa ore per secilen here, duke dhene deklarime teper te hollesishme lidhur me kete kallezim.

2. Prokuroria e Pergjithshme, Prokuroria e Tiranes dhe Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, Dhoma Penale, nuk me kane njoftuar per kalimin e kesaj dosjeje prane Prokurorise se Tiranes dhe nuk kane bere asnje njoftim sipas parashikimeve ligjore, lidhur me pushimin e ceshtjes.

- 2.01 Kaluan disa muaj dhe nga media mesoj se, dosja kishte kaluar ne Prokurorine e Tiranes dhe se kjo prokurori, kishte kerkuar pushimin e kesaj ceshtjeje, vetem pak dite pasi dosja u mor prej saj.
- 2.03 Ne shkelje te plote te KPrP, une nuk jam njoftuar nga kjo prokurori lidhur persa me siper, si dhe nga gjykata gjithashtu.
- 2.04 Kerkova me urgjence nje informacion nga Prokuroria, se cfare po behej me kallezimin tim dhe ata me informuan lidhur me kerkesen per pushimin e saj, si dhe kalimin e dosjes prane Prokurorise se Tiranes.
- 2.05 Pasi e rivendosa ne afat te drejten time te ankimit, une iu drejtova Gjykates se Tiranes, duke kerkuar qe te njihem fillimisht me aktet.
- 2.06 Me pas une kam pergatitur nje objeksion voluminoz, ku argumentoja se, pushimi i kesaj ceshtjeje, nuk duhej te pranohej dhe se dosja duhej kthyer per plotesim hetimi.
- 2.07 Gjykata ne daten 15.12.2017 e pranoi kerkesen time dhe te Kuvendit te Shqiperise dhe e kthehu dosjen per plotesim hetimi.
- 2.08 Per mbi dy vjet, gjykata dhe prokuroria jane takuar ne seanca te rregullta lidhur me kete ceshtje, por, mua nuk me kane njoftuar asnjehere, duke shkelur hapur parashikimet ligjore te KPrP, perkatesisht te neneve 328 dhe 329 te tij, duke shperdoruar hapur ne lidhje me detyren e tyre.
- 2.08 Mbas kalimit te nje periudhe dy vjecare, perseri mesoj nga media se, Prokuroria e Tiranes ka kerkuar pushimin e kesaj ceshtjeje.
- 2.09 Perseri iu drejtova gjykates, ne dhjetor 2019 dhe kerkova te njihem me aktet, si dhe te kem kohen e duhur, per te pergatitur objeksionet e mia, gje qe u pranua.

3. Gjykatesi Sallaku rrezoi kerkesen per konstatim te moskompetences si dhe vendosi padrejtesisht pushimin e ceshtjes.

- 3.01** Me datën 24.01.2020, gjyqtari i ceshtjes Lazer Sallaku, fillimisht rrezoi kërkesën për konstatim kompetence, duke qenë e parashtruar kjo kërkesë nga Kuvendi i Shqipërisë dhe e perkrahur nga unë, dhe më pas vendosi pushimin e ceshtjes, duke rrezuar kërkesën time dhe të Kuvendit për një rikthim të dosjes për plotësim hetimi.
- 3.02** Ky vendim pushimi, ishte i parapërgatitur dhe nuk mori fare parasysh objeksionet e mia dhe të Kuvendit të Shqipërisë, pasi u deklarua menjëherë, pasi unë dhe Kuvendi i Shqipërisë i ofruam ato, pa u lexuar dhe shqyrtuar nga gjyqtari Sallaku.
- 3.03** Ky vendim pushimi bie në kundërshtim me vetë vendimin e po këtij gjyqtari të datës 15.12.2017, kur ai e rrezoi kërkesën e pushimit të kësaj ceshtjeje nga ana e prokurorisë dhe e kthehu dosjen për plotësim hetimi.
- 3.04** Qëndrimi i prokurorisë vazhdoi të mos ndryshojë për mbi dy vjet, pra pa asnjë hetim shtesë, ndërsa për çudi qëndrimi i gjyqtarit ndryshoi.

4. Prokuroria e Tiranës nuk ka kryer asnjë hetim lidhur me ceshtjen.

- 4.01** Prokuroria nuk e zbatoi fare vendimin e gjykates për të bërë një hetim të gjithanshëm dhe të hollësishëm të ceshtjes, por, realizoi vetëm katër-pesë deklaramë të pavlera dhe jo në funksion të zbardhjes së ceshtjes.
- 4.02** Duke mos pyetur të gjithë personat e kallezuar si dhe të tjerë të përfshirë në këto afere, si dhe duke mos kërkuar qëllimisht prova në mbështetje të fakteve të gjetura nga unë dhe Kuvendi i Shqipërisë, prokuroria faktikisht, nuk ndryshoi asgjë në punën e saj dhe kjo gjë duhej të konstatohej nga gjykatesi Sallaku.
- 4.03** Për të njëjten dosje, qëndrim dhe punë, gjyqtari Sallaku dha dy vendime të ndryshme në dhjetor 2017 dhe në janar 2020.

5. Gjyqtari Sallaku nuk mori parasysh provat dhe faktet e ofruara nga unë dhe Kuvendi i Shqipërisë.

- 5.01** Vendimi i janarit 2020 ishte teresisht i pambështetur në ligj, pasi ky vendim nuk mori parasysh as faktet dhe as provat e shumta, të ofruara nga unë dhe Kuvendi i Shqipërisë, si dhe as inaktivitetin e qëllimshëm të Prokurorisë së Tiranës.
- 5.02** Vendimi i gjyqtarit ishte i padrejtë edhe për vetë arsyen se, gjykata të cilën ai përfaqëson, as nuk i ka pasur për kompetencë lëndore veprat penale të kallezuara nga unë dhe as nuk nuk do t'i këte

pasi ato i kane kaluar per kompetence Gjykates Speciale Kunder Korruspionit dhe Krimet te Organizuar. Po keshtu kjo gjykate nuk ka pasur tager qe te gjykoje personat e kallezuar per vete cilesine e tyre te vecante.

Ato kane qene objekt vetem i Gjykates se Larte.

6. Gjyqtari Sallaku lejoi qellimisht nje cilesim te manget juridik te veprave penale.

- 6.01** Vendimi i gjyqtarit eshte i padrejte edhe per arsyen se, ai lejoi nje cilesim qellimisht te gabuar te vepres penale nga ana e prokurorise, gje qe u kontestua disa here nga ana ime. Prokuroria beri vetem dy cilesime juridike te vepres penale, ate te ndikimit te paligjshem dhe ate te pastrimit te produkteve te vepres penale, nderkohe qe ne menyre te qarte dhe pa asnje ekuivok, mund te konstatohen veprat penale te shperdorimit te detyres, te korrupsionit dhe shkeljes se barazise neper tenderat publike etj. Gjykatesi Sallaku me vetedije te plote, nuk mori parasysh objeksionet tona dhe nuk e pranoi nje cilesim te sakte te veprave penale te kryera pergjate procedures se privatizimit te OSSH-se.

7. Gjyqtari Sallaku nuk mori parasysh provat e reja te ofruara nga une dhe Kuvendi i Shqiperise.

- 7.01** Pergjate investigimit tim, as prokuroria dhe as gjykata nuk moren parasysh nje sere provash te reja te ofruara nga une, te cilat i japin nje tjeter kendveshtrim te gjithë ngjarjes, duke hequr cdo dyshim, persa i perket ndikimit te paligjshem dhe shkeljes te barazise neper tenderat publike. Keto prova te reja hedhin poshte edhe tezen se, kjo ceshtje ishte gjykuar njehere ne vitin 2016 nga Gjykata e Larte, dhe se prevalonte parimi i gjese se gjykuar. Nese do te prevalonte ky parim, atehere gjykata do ta konstatohte kete gje qe ne vitin 2017 dhe nuk do te duhej t'a kthente dosjen per plotesim hetimi. Pasi nuk gjeten argument tjeter per t'a pushuar kete ceshtje, prokuroria dhe gjykata iu kthyen perseri kesaj teze, por tashme me shume vonese.

8. U lejua qe prokuroria te beje nje hetim ngushtues te kesaj afere.

- 8.01** Vendimi i gjyqtarit ishte i pajustificuar pasi prokuroria nuk ka kryer pothuaj asnje veprim hetimor, nuk realizuan paraprakisht nje hetim te plote dhe te gjithanshem te ngjarjes, por perkundrazi u mjaftuan vetem me nje hetim qesharak, insuficient dhe ngushtues te kesaj afere.

9. Gjyqtari Sallaku qellimisht nuk konstatoi veprat e shumta penale dhe shkeljet e hapura ligjore te kryera pergjate kesaj afere.

9.01 Vendimi i gjyqtarit Sallaku eshte teresisht i padrejte, pasi ne mjaft raste ai ka refuzuar qe te konstatoje shkelje te renda ligjore pergjate zhvillimit te procedures se tenderimit, te cilat konsistojne ne, shkeljen e afateve te kesaj procedure, parregullsi ne ngritjen e komisioneve, ndryshimin e specifikimeve teknike pas hapjes se ofertave, mosnenshkrimin e kontrates brenda 30 diteve nga njoftimi i fituesit, mossekuestrimin e ofertes kur deshton qe kontrata te lidhet brenda 30 diteve nga njoftimi i fituesit, vendosjen e shumes se sigurimit te ofertes ne kundërshtim me ligjin, favorizime te paligjshme te CEZ-it duke bere rivleresime te asetëve ne dem te buxhetit te shtetit, zhvillimin e nje procesi te paligjshem negociimi etj, referimi qellimisht i gabuar i bilanceve jozyrtare etj.

10. Gjyqtari Sallaku brenda nje kohe te shkurter, beri dy pushime teper te kontestueshme te ceshtjeve penale, qe kane lidhje me forcen politike PD, duke favorizuar hapur drejtuesit dhe ishdrejtuesit e saj.

10.01 Vendimi i pushimit te ketij gjyqtari vjen menjehere pas nje vendimi tjetër pushimi qe ai dha, per nje tjetër ceshtje sensitive, qe kishte lidhje me kryetarin e PD, Lulzim Basha dhe lobimin shume te perfolur rus. i cili gjithashtu eshte ankimuar.

11. Prokuroria ka pyetur vetem nje person nga 16 qe jane kallezuar prej meje.

11.01 Edhe pse une kam kallezuar 16 persona, prokuroria ka marre ne pyetje vetem nje prej tyre, ish ministrin Ruli, duke mos pyetur asnje me teper, gje qe flet per nje mungese totale hetimi dhe qe u pranua si normale nga gjyqtari Sallaku.

Kjo frike per te pyetur, e jo me pastaj per te hetuar, per te zbuluar shkaqet se perse nuk jane respektuar afatet e tenderimit, se perse nuk eshte respektuar ligji lidhur me ngritjen e komisioneve te kesaj procedure, se perse u ndryshuan specifikimet teknike etj, justifikohet vetem me nje venie ne sherbim te prokurorise dhe gjykates, ndaj te kallezuarve prej meje dhe Kuvendit te Shqiperise.

Ne te vertete gjykata dhe prokuroria ne kete rast, vepruan hapur si avokate te te kallezuarve, duke vepruar hapur pro tyre, ne shkelje te ligjit dhe shperdorimit te detyres, biles pothuaj te kordinuar plotesisht si nje grup i strukturuar kriminal.

12. Nje hetim i plote i kesaj afere patjeter qe do te conte edhe ne zbardhjen e mjaft aferave te tjera te kryera ne sektorin energjetik shqiptar.

- 12.01** Jam i sigurte se, pervec veprave penale te zbuluara prej meje, nje investigim i plote i kesaj ceshtjeje, do te coje ne zbulimin e te tjerave veprave penale, qe kane te bejne me kete procedure privatizimi, si dhe me pasojat e saj.

Kapitulli II

Problematikat kryesore qe une kam kostatuar lidhur me ceshtjen e privatizimit te OSSH-se.

13. Procesi i privatizimit te OSSH-se ka qene i nxituar.

- 13.01** Banka Boterore dhe Komisioni European kane konstatuar se, procesi i privatizimit ka qene i nxituar.
- 13.02** Ne Dhjetor te Vitit 2012, kur marredhenia ndermjet CEZ-it dhe Shtetit Shqiptar ishte ne kulmin e perkeqesimit, Drejtoresha e Bankes Boterore per Shqiperine, Kseniya Lvovsky ka theksuar se, **“procesi i privatizimit te OSSH-se ishte i nxituar, edhe pse Banka Boterore e pati mbeshtetur nje hap te tille”.** (E. 1)
- 13.03** Rezulton se nga ana e prokurorisë nuk eshte pyetur, dhe as nu eshte tentuar te pyetet znj. Lvolsky per te mesuar se, perse sipas saj dhe Bankes Boterore, ky proces ishte i nxituar, se cilat ishin pasojat e ketij nxitimi si dhe cilet persona jane pergjegjes per kete nxitim, me pasoja fatale per buxhetin e Shtetit Shqiptar.
Nuk eshte bere asnje analize se, nese ky proces do te ishte bere pa u nxituar, cilat do te ishin hapat dhe perfitimet.
- 13.04** Po keshtu, Zv. Ministri i Integritimit te asaj kohe, Albert Gajo, ne Mbledhjen e Qeverise se dates 17.09.2008, pikerisht 12 dite para afatit te dorezimit te ofertave teknike dhe financiare, ka theksuar se: **“... shqetesimi kryesor qe ngriten specialistet me shume miredashje te Komisionit European ishte se ne kete situatë qe eshte OSSH-ja, pra KESH• i ne pergjithesi, qe ju vet me shifrat tuaja, eshte negative, eshte me bilanc negativ, qe del me humbje. Se nje ndermarrje qe del me humbje likujdohet, nuk privatizohet. Pra kjo eshte me e thjeshte se sa ky diskutim qe ne mundohemi te komplikojme. Ne qofte se bilanci eshte i certifikuar i OSSH-se, i audituar dhe eshte me vlere negative, nuk mund ta privatizosh ose do te presesh deri ne moment in qe ai te kete bilanc pozitiv”.**
Kete material po e percjell fiks ashtu sic eshte shkruar ne process-verbalin perkates te mbledhjes se qeverise. (E. 2)
- 13.05** Theksoj se Albert Gajo nuk eshte pyetur nga prokuroria, per te sqaruar pozicionin e tij dhe ate te Komisionit European ne lidhje me kete proces privatizimi.

- 13.06** Nuk ishte zgjidhur problematika e titujve te pronesise midis OSSH-se dhe KESH-it. Nje arsye tjeter, pse kjo procedure privatizimi ishte e nxituar, eshte moszgjidhja e problematikes se titujve te pronesise, per asetet e OSSH-se, te cilat i perkasin nje pjese akoma edhe sot KESH-it. Keshtu ne daten 14 Janar 2008, me ane te shkreses Nr. 393 prot, zv. Ministri i METE-s, Neritan Alibali, i drejton nje leter KESH-it dhe ERE-s, ku kerkon qe te merren hapat e nevojshem per realizimin e procedurave te vleresimit te aseteteve. **(E. 6)**
- 13.07** Ne daten 9.5.2008, ne me pak se nje muaj perpara hapjes se procedurave per fazen e pare te tenderit, Ministri i METE-s Genc Ruli, me ane te Vendimit Nr.4, autorizon fillimin e procedurave per transferimin e titujve te pronesise te OSSH-se nga KESH-i te METE. **(E. 7)**
- 13.08** Lidhur me kete problematike kemi edhe Urdherin Nr.329, date 9.5.2008 te METE-s **(E. 8)**.
- 13.09** Po keshtu kemi edhe Urdherin Nr. 329/1 date 12.5.2008 firmosur nga Neritan Alibali drejtuar KESH-it lidhur me transferimin e titujve te pronesise. **(E. 9)**
- 13.10** Ne daten 8 Korrik 2008, me ane te shkreses Nr.6466, Ministri Genc Ruli i kerkoi Zyres Qendrore te Pasurive te Paluajtshme, pershpjtimin e procedurave per rregjistrimin e pasurive te paluajtshme te OSSH-se. **(E. 10)**
- 13.11** As ky aspekt, nuk eshte investiguar nga prokuroria, por vetem jam cituar une persa me siper dhe gjykata nuk konstatorn asnje parregullsi dhe shkelje, ku po shiten disa asetet dhe aksione, pa u zoteruar me pare pronesia e tyre ligjore. A eshte normale zhvillimi i nje procedure privatizimi pa u zgjidhur akoma problemet me titujt e pronesise?
- 13.12** Eshte hyre ne privatizim pa u krijuar e testuar Modeli i Ri i Tregut dhe per me teper, pa vene ne dijeni ERE-n, per detajet lidhur me kete privatizim. Ne letren Nr.1211, date 11.1.2008, Kryetari i ERE-s, Bujar Nepravishta, kerkoi nje informacion te plote e me te detajuar lidhur me kete proces privatizimi. Nga ceshtjet qe ai trajtoi ne kete leter, kuptohet se ERE nuk ka qene ne dijeni as per parametrat ligjore te ketij privatizimi, jo me per detajet. **(E. 11)**
- 13.13** Rezultoni se nga ana e prokuroris se nuk eshte pyetur ish kryetari i ERE-s Bujar Nepravishta lidhur persa me siper. Ai ka qene nje aktor shume i rendesishem me pas ne teatrin e kesaj shfaqjeje. Gjykata nuk e konstatoi se mospyetja e ketij personi perben nje shkelje te vete vendimit te saj 240 date 15.12.2017 ku ajo ka urdheruar prokurorine per hetime te plota dhe te gjithanshme.
- 14. Mos aplikimi i legjislacionit te duhur per kete lloj privatizimi.**
- 14.01** Qeveria e atehershme perdori proceduren e tenderit te hapur nderkombetar, per te realizuar shitjen e 76% te aksioneve te OSSH-se, nderkohe qe dihet fare mire se, per procedurat e shitjes perdoret ankandi dhe jo tenderi.

Tenderi perdoret si procedure blerjeje.

Ne ankand karakteristike eshte cmimi dysHEME ndersa ne tender eshte cmimi tavan.

- 14.02** Ky fakt, nuk eshte marre parasysh as nga prokuroria dhe as nga gjykata, pasi per shitje procedura e duhur eshte vetem ajo e ankandit.
Prokuroria as qe ka hetuar fare lidhur me arsyet reale te perdorimit te kesaj procedure. Gjukata gjithashtu nuk e konstatoi kete mungese hetimi. Fakti eshte qe, mireadministrimi i nje procesi te tille, nuk do te duhej te behej me kete lloj procedure.
- 15. Rrenimi total i procedures se tenderit pas hapjes se ofertave ne 29.09.2008.**
- 15.01** Realiteti i zhvillimit te kesaj procedure, flet qarte per nje miksim te vertete te procedures se tenderit dhe ankandit, pasi pas hapjes se ofertave ne daten 29 Shtator 2008, ka filluar nje maratone negocimesh, te denja vetem per nje ankand, duke zhvleresuar cdo kerkese teknike dhe ekonomike, te vendosur ne Dokumentat e Tenderit, si kushtet minimale teknike te detyrueshme, te cilat duhet te ishin te panegociueshme.
- 15.02** Asnje hetim nuk eshte bere nga ana e prokurorise persa me siper. A eshte normale qe, procedura te nise si nje tender i hapur dhe pastaj, pikerisht pas hapjes se ofertave dhe njoftimit te fituesit, te perfundoje si nje procedure negocimi e paparashikuar fare ne asnje klauzole ligjore apo klauzole ne dokumentat e tenderit? Sigurisht qe jo, por gjykata nuk pati deshiren per t'a konstatuar kete anormalitet me pasoja fatale ekonomike.
- 15.03** Dokumentat e tenderit te hapur nderkombetar per privatizimin e 76% te aksioneve te OSSH-se jane miratuar nga qeveria shqiptare pikerisht nepemjet dy VKM-ve: VKM Nr. 487, date 16.04.2008 "Per kriteret e perzgjedhjes se investitoreve strategjike, te interesuar per blerjen e aksioneve te shoqerise "Operatori i Sistemit te Shperndarjes"sha" (E. 4) dhe VKM Nr. 835, date 11.06.2008 "Per percaktimin e madhesis se paketes se aksioneve te kapitalit, te shoqerise anonime "Operatori i Sistemit te Shperndarjes", qe u ofrohet investitoreve strategjike". (E. 5)
- 15.04** Si ka mundesi qe, ato specifikime teknike, qe jane vendosur nga qeveria shqiptare nepermjet ketyre akteve nenligjore, u rrezuan nga nje komision negocimi?
Perse nuk i ka terhequr vemendjen prokurorise dhe gjykates nje nje fakt i tille?
- 16. Nuk ishin zgjidhur marredheniet e detyrimeve ndermjet KESH-it dhe OSSH-se.**
- 16.01** Ne kete proces privatizimi, jo vetem qe nuk ishin zgjidhur marredheniet e pronesis, por mbi te gjitha, nuk ishin zgjidhur paraprakisht si duhet as marredheniet dhe detyrimet ndermjet KESH-it dhe OSSH-se.

- 16.02** Ne daten 2 Shkurt 2008 me shkresen Nr.1210, Ministri Ruli, kerkon mendim nga ishministri Bode, midis te tjerave, per borxhin rreth 400 milion dollare, qe i eshte krijuar KESH-it, per arsye te faturave te papaguara te energjise elektrike. **(E 12)**
Ne dokumentat e mevonshme, nuk permendet se, si u trajtua kalimi i ketij borxhi dhe si e sa u arketua ky borxh nga CEZ-i gjate menaxhimit te tij.
- 16.03** Nuk ka ndonje investigim te prokurorise persa me siper, si dhe as ndonje qendrim te gjykates edhe se perse ky fakt eshte shume i rendesishem, nuk eshte trajtuar fare. Sic do t'a trajtoj me pas, pasojat jane vetem prej ketij fakti jane, jo me pak se 70 milion USD apo 55 milione euro.
- 16.04** Me urdherin Nr.2, date 12 Shkurt 2008 te Komitetit te Konsulences dhe Transparences, Kryetar i te cilit ishte Genc Ruli, theksohet se, KESH-i duhet te raportoje per ecurine e punes ne lidhje me detyrimet e huave qe do t'i kalojne OSSH-se. **(E. 13)**
- 16.05** Me Urdherin Nr. 329, date 11 Maj 2008 te Ministrit Ruli, kerkohet reflektimi i ndryshimeve ne bilancin e shoqerise KESH. **(E. 8)**
- 16.06** Ne daten i Korrik 2008, ishministri Ruli ka nxjerre Urdherin Nr. 500 "Per ndarjen e te drejtave dhe detyrimeve ndermjet KESH dhe OSSH si dhe marredheniet tranzitore ndermjet tyre". **(E. 14)**
- 16.07** Pra edhe pse kishte kaluar nje muaj nga hapja e procedurave te privatizimit, detyrimet ndermjet KESH-it dhe OSSH-se nuk ishin ndare akoma.
- 16.08** Pak vite me pas, ky Urdher eshte perdorur disa here nga drejtuesit cek te CEZ-it Shperndarje, kunder qeverise shqiptare, si prove per mosshlyerjen e detyrimeve.
- 16.09** Nuk ka asnje hetim dhe opinion te prokurorise persa me siper. Cili do te ishte justifikimi per t'a konsideruar normale sipas prokurorise dhe gjykates, zhvillimin e nje procesi privatizimi ne kete rast, pa u zgjidhur marredheniet e detyrimeve ndermjet KESH-it dhe OSSH-se?
- 17. Ceshtja e pronesise se pasurive te paluajtshme ndermjet KESH-it dhe OSSH-se.**
- 17.01** Kjo ceshtje eshte tentuar te zgjidhet me ane te VKM Nr. 1108, date 30 Korrik 2008 "Per miratimin e listes se inventarit te pronave te paluajtshme shtetore, te cilat kalojne ne pronesi te Operatorit te Sistemit te Shperndarjes, sha". **(E. 15)**
Edhe kjo VKM, pervecse ka dale me shume vonese dhe vetem pak jave para hapjes se ofertave te Fazes se dyte te tenderit, nuk e ka zgjidhur kete problem, pasi akoma edhe sot ka mjaft konflikte gjyqesore lidhur me pronesine e subjekteve qe kane certificate pronesie per pronat qe i kane kaluar OSSH-se me kete VKM.
- 17.02** Perseri nuk kemi nje hetim te prokurorise edhe pse konstatimi i kesaj problematike eshte fare i thjeshte. Gjykata e konsideroi normale nje fakt te tille.

18. Modeli i Tregut te Energjise Elektrike eshte ndryshuar disa here.

18.01 Pergjate zhvillimit te ketij procesi, Modeli i Tregut te Energjise Elektrike eshte ndryshuar disa here, gje qe eshte krejt e pazakonte, pasi jo vetem flet per nje mungese pergatitje nga ana e legjislacionit, por edhe per nje ndryshim te rregullave te lojes gjate procesit. Ky fakt provohet nga Vendimet e meposhtme te Keshillit te Ministrave:

- VKM Nr.628, date 3 Tetor 2007 "Per miratimin e Modelit te Tregut te Energjise Elektrike"; **(E. 16)**
- VKM Nr.338, date 19 Mars 2008 "Per miratimin e Modelit te Tregut te Energjise Elektrike". **(E. 17)**

18.02 Deklarata rregullatore e ERE-s eshte ndryshuar kater here branda nje kohe te shkurter, ne varesi te zhvillimeve te procesit te privatizimit. Kjo gje eshte e pazakonte dhe per me teper kur kjo deklarate ishte pjese perberese e dokumentave te tenderit dhe ndryshimi i saj, sidomos pas hapjes se ofertave dhe njoftimit per shpalljen e fituesit, perbente edhe ndryshim te specifikimeve teknike dhe kushteve te tjera te parashikuara ne dokumentat e tenderit.

18.03 Nga ana e prokurorise nuk eshte pyetur as ish kryetari i ERE-s, Bujar Nepravishita, si dhe as bordi i atehereshem i ERE-s lidhur persa me siper.

18.04 Fakti qe prokuroria nuk ka bere asnje investigim dhe trajtim te kesaj ceshtjeje, nuk do te thote se, keto veprime jane te mbeshtetura ne ligj dhe pa pasoja negative financiare.

18.05 OSSH-ja duhet te hynte ne procesin e privatizimit, vetem pas ndarjes se te gjitha te drejtave dhe detyrimeve me KESH-in, adoptimit dhe mirefunksionimit me Modelin e Ri te Tregut, si dhe pas daljes te legjislacionit te duhur ne lidhje me kete proces privatizimi.

18.06 Perse u nxitua per te hyre ne kete procedure privatizimi?

Cilat jane arsyet e ketij nxitimi?

Cilat jane pasojat e ketij nxitimi?

Kush jane personat pergjegjes?

Per te gjitha keto pyetje nuk u mor asnje pergjigje nga ana e prokurorise, e cila nuk e ka investiguar aspak kete aspekt si dhe nuk u pa asnje trajtim nga ana e gjykates.

19. Eshte shkelur e gjitha baza ligjore mbi te cilin u krye privatizim.

19.01 Gjate investigimit te procedurave te privatizimit, u konstatuan nje sere shkeljesh te renda ligjore si me poshte:

Baza ligjore mbi te cilin u krye privatizimi ishte Ligji Nr.8306, date 14.03 .1998 "Per privatizimin e sektoreve me rendesi te vecante", i ndryshuar. **(E. 18)**

Ky ligj parashikonte se, kriteret e pergjithshme per privatizimin, kriteret e percaktimit te investitoreve strategjike, procedura e perzgjedhjes si dhe formula e privatizimit, percaktohen rast pas rasti nga Keshilli i Ministrave.

- 19.02** Ligji parashikon ne nenin 10 te tij se, shteti, per mbrojtjen e interesave te tij publike dhe strategjike, mban ne pronesi nje pakete aksionesh ose "Aksionin e Arte". Me ane te ketyre mekanizmeve, shteti rezervon te drejten per te mbrojtur interesat e veta strategjike dhe publike. **(E. 18)**
- 19.03** Ne realitet, kjo porosi ligjore nuk eshte zbatuar ne kete rast, pasi me ane te VKM Nr. 835, date 11 Qershor 2008 "Per percaktimin e madhesis se paketes se aksioneve te kapitalit, te shoqerise "OSSH", qe u ofrohet investitoreve strategjike" **(E. 5)**, madhesia e kapitalit te OSSH-se qe u ofrohej investitoreve strategjike, ishte 76 %.
- 19.04** Duke miratuar kete pakete aksionesh, Keshilli i Ministrave nuk mori parasysh mbrojtjen e interesave strategjike te shtetit shqiptar.
- 19.05** Dhenia per privatizim e 76 % te aksioneve, i dha te drejte CEZ-it qe te zoteronte Asamblene e Pergjithshme te kompanise me mbi 3/4 e votave.
- 19.06** Ishte pikerisht ky prag i privatizimit te aksioneve qe sipas nenit 87 te Ligjit 9901 date 14.04.2008, **(E.19)** i dha te drejte ligjore stafit drejtues te CEZ-it, qe te ndryshonte statutin, te shperndante fitimet, te riorganizonte shoqerine, bile edhe ta prishte fare ate. Jo rastesisht kemi edhe hyrjen ne fuqi te ketij ligji pikerisht pak perpara berjes se kesaj procedure privatizimi, ne maj 2008.
- 19.07** A nuk mendoi prokuroria se, berja e ligjit per ndermarrjet tregtare, pikerisht me 14.04.2008, pak perpara se te zhvillohej kjo procedure privatizimi ka lidhje me kete procedure dhe i ka sherbyer si garanci pales ceke, per te hyre ne kete privatizimin?
Perseri nuk ka nje investigim te prokurorise persa me siper si dhe nje konstatim te drejte te gjykates.
- 19.08** E gjithë procedura e shkruar dhe e pashkruar e miratimit te ketij ligji do te duhej te hetohej, sepse ka pasur te beje pikerisht me privatizimet e pasurise me me vlere dhe me te rendersishme te vendit.
- 20. Mosrespektimi i afateve kohore te parashikuara nga ligji.**
- 20.01** Neni 11 i Ligjit 8306, date 14.03.1998 "Per privatizimin e sektoreve me rendesi te vecante", percakton se, per zbatimin e procedurave te privatizimit, qe nga momenti i publikimit, duhet te respektohet nje afat minimal 3 mujor, me qellim sigurimin e transparences. **(E. 18)**
- 20.02** Ne realitet, privatizimi i OSSH-se nisi me Ligjin Nr. 9889, date 20.03.2008 "Per percaktimin e formes dhe te struktures se formules se privatizimit te Shoqerise anonime "OSSH", **(E. 20)** ndersa ofertat per parakualifikimin dolen ne daten 2 Qershor 2008, pra ne me pak se 3 muaj nga sa ishte parashikuar ne afatin minimal ligjor.
- 20.03** Si ka mundesi qe nuk kane konstatuar shkelje ligjore prokuroria dhe gjykata persa me siper?
Si e konsiderojne ato keto shkelje te afateve ligjore?
Perse nuk e ka hetuar prokuroria se cila ishte arsyeja e kesaj shkeljeje ligjore?
A ka favorizuar kjo shkelje ligjore CEZ-in qe kishte kater vjet qe parapergatitej?

A ka disfavorizuar kjo shkelje ligjore konkuruesit e tjere te mundshem, duke mos i dhene kohe te mjaftueshme atyre per t'u pergatitur dhe per te marre pjese ne tender?

A eshte shkelur parimi i barazise se tenderit? Sigurisht qe po.

- 20.04** VKM Nr.835, dt 11.06.2008, palet duhet nenshkruanin Marreveshjen per Blerjen e Aksioneve duke u bazuar ne oferten e paraqitur nga CEZ-i, brenda 30 diteve nga shpallja e fituesit. Kjo gje nuk ka ndodhur pasi marreveshja u nenshkrua mjaft muaj me pas.
- 20.05** Prokuroria nuk ka dashur t'a hetoje apo t'a konstatoje kete shkelje ligjore. Arsye tjeter une nuk shoh dhe pranoj se, perse nuk konsiderohet veper penale nje fakt i tille. Fakti eshte aty kokeforte dhe i takonte prokurorise qe te hetonte dhe gjente te gjitha provat e tjera edhe pse ky fakt nuk ka fare nevojte qe te provohet.
- 20.06** Po gjykata si ka mundesi qe nuk e konstaton nje fakt te tille?
- 20.07** A ka llogjike qe te shohesh dhe konstatosh shkelje te pastra dhe te renda ligjore dhe pastaj te thuash qe nuk ka veper penale?
- 20.09** Nuk eshte respektuar neni 43, pika 2 e ligjit per prokurimin publik lidhur me afatet kohore te dorezimit te ofertave. Sipas ligjit te prokurimit, ky afat duhet te ishte jo me pak se 52 dite nga data ne te cilen eshte botuar njoftimi i prokurimit.
- 20.10** Njoftimi per tenderin eshte bere ne daten 9.5.2008 me Vendimin Nr.3, date 9.5.2008 te Komitetit te Konsulences dhe Transparences dhe procedura per parakualifikimin ka filluar ne daten 2 Qershor 2008, pra vetem 23 dite ne nje kohe qe sipas ligjit duhet te ishte 52 dite. **(E. 39)**
- 20.11** Perseri prokuroria nuk e ka trajtuar kete shkelje te afateve proceduriale. A do te kishte te mundur nje kompani serioze te pergatiste ofertat e saj ne kaq pak kohe? A nuk eshte ky mosrespektim i afateve ligjore nje favorizim per kompanine CEZ e cila ishte ne dijeni te procesit sipas Nuel Kalajt qe ne 2005? Perseri gjykata nuk konstatoi nje shkelje te paster ligjore e cila nuk ka nevojte per asnje prove qe te provohet.
- 20.12** Nuk eshte respektuar parashikimi ligjor lidhur me afatin tre mujor per sigurimin e transparences se procedures.
- 20.13** Neni 11 i Ligjit 8306 te vitit 14.03.1988 "Per privatizimin e Sektoreve me Rendesi te Vecante": Per percaktimin e procedurave te privatizimit qe nga momenti i publikimit duhet te respektohet nje afat minimal tre mujor, me qellim sigurimin e transparences, Vendimi i Komitetit te Konsulences dhe Transparences nr3 dt 09.05.2008 i firmosur nga kryetari i ketij Komiteti dhe qe parashikonte publikimin e shprehjes se interesit vetem 25 dite perpara dates se dorezimit te ofertave parakualifikuese.
- 20.14** Ky afat i detyrueshem ligjor nuk eshte respektuar. Perseri prokuroria ka mbyllur syte dhe e ka lene jashte investigimit te saj kete fakt dhe gjykata nuk e ka konstatuar gjithashtu kete fakt, i cili eshte teresisht i provuar.

- 21. Mosrespektimi i Ligjit Nr.9889, date 20.03.2008 "Per percaktimin e formes dhe te struktures se formulese se privatizimit te Shoqerise anonime "OSSH", (E. 20)**
- 21.01** Ne nenin 3 te ligjit te permendur ne piken 1.5 me siper (E. 20), parashikohet se, pjesa e mbetur e aksioneve te OSSH (24 % ne kete rast), duhet t'u ofrohej:
- a) ish-subjektevete shpronesuara te truallit dhe te ndertesave;
 - b) punonjesve te OSSH, sha-se, ne shkembim te aksioneve me bonot e privatizimit apo letrave me vlere;
 - c) te persekutuarve;
- 21.02** Akoma edhe sot, nuk kemi gjetur asnje lloj akti ligjor apo nenligjor apo veprim administrativ, i cili mund te faktoje zbatimin e ketij percaktimi ligjor.
- 21.03** Edhe kjo ceshtje nuk eshte trajtuar nga prokuroria dhe as eshte permendur si shkelje ligjore.
- 21.04** Eshte detyra e saj t'a konstatoje kete shkelje te hapur te ligjit si dhe te percaktoj arsyet dhe pergjegjesit e kesaj shkeljeje ligjore.
- 21.05** Po keshtu per gjykaten mosrespektimi i kesaj klauzole ligjore, me ane te te cilit iu nderrua destinacioni ligjor i ketyre te ardhurave, nuk perben shkelje te ligji, abuzim me detyren etj.
- 21.06** Neni 5 i po ketij ligji, parashikon se, te ardhurat nga privatizimi do te perdoreshin per:
- a) mbulimin e shpenzimeve per organizimin e procedurave te tenderit dhe per veprimtari te tjera, qe nevojiten ne procesin e privatizimit;
 - b) pagesen e tarifese se suksesit shoqerise se pavarur konsulente, te kontraktuar nga Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes;
 - c) shperblimin e komisionit te vleresimit te ofertave te Komitetit te Konsulences dhe Transparences, si dhe te grupit te negociimit, sipas percaktimeve te Keshillit te Ministrave;
 - d) trajtimin e punonjesve, qe do te dalin te papune nga procesi i ristrukturimit te OSSH-se, ne kuader te privatizimit te saj.
- 21.07** Ne kuader te ketij privatizimi, u nxorren si te papune minimalisht 1400 punonjes (750 me pushimin e pare kolektiv dhe 650 me pushimin kolektiv te dyte), te cilet kurre nuk e moren kete trajtim ligjor si kompensim per lenien e tyre pa pune, perkundrazi punonjesit e OSSH-se jane rropatur dyerve te gjykatave duke vertetuar edhe nje here demin social qe solli ky privatizim.
- 21.08** Perseri kemi nje injorim te prokurorise dhe gjykates perballe shkeljeve te pastra ligjore. Kushdo qe i ka administruar ndryshe keto te ardhura, ka kryer minimum shperdorim detyre. As prokuroria dhe as gjykata nuk realizuan asnje investim lidhur persa me siper, pasi ishin te sigurta se, do te konstatonin shperdorimin e detyres.

22. Eshte paguar dy here shoqeria konsulente IFC, njehere me ligj dhe njehere me VKM.

22.01 Ne Ligjin Nr. 9889, date 20.03.2008 "Per percaktimin e formes dhe te struktures se formules se privatizimit te Shoqerise anonime "OSSH", (**E. 20**), parashikohet se: nga parate e fituara nga shitja e 76% te aksioneve te OSSH-se, do t'i paguhet nje tarife suksesi firmes konsulente IFC ne masen 3% te pageses te ketyre aksioneve.

22.02 Me ane te VKM Nr. 835, date 11 Qershor 2008, imponohet ofertuesi fitues, qe te paguaje tarifen e suksesit per shoqerine konsulente, pavaresisht se, me ane te ketij ligji, keto pagesa duhet te kryheshin nga te ardhurat e ketij privatizimi.

22.03 Sic shihet, me ligj detyrohet shitesi, pra Shteti Shqiptar qe t'a paguaje kete pagese, ndersa me VKM detyrohet bleresi, pra CEZ-i qe t'a paguaje kete pagese e cila eshte ne masen 3% te shumes se privatizimit saktesisht ne masen e 3.6 milione eurove.

22.04 Kjo shume, me sa duket i eshte paguar dy here nga 3.6 milione euro firmes konsulente IFC.

22.05 Une nuk shoh qe t'i jete bere ndonje trajtim kesasj ceshtjeje nga ana e prokurorise.

Se pari: mesa dihet ligjerisht, kjo success fee, nuk duhej aplikuar fare ne kete rast, pasi ky privatizim rezultoi fare i pasuksesshem.

Se dyti: une shoh nje mekanizem shume djallezor per t'a paguar dy here firmen IFC, ne menyre te jashteligjshme edhe pse ne plan ne pare duket sikur te dyja pagesat mbeshteten ne ligj.

22.06 As ligji dhe as VKM nuk kane te parashikuar apo te shprehur se: gjysma apo nje pjese e tarifes se suksesit do te paguhet nga Shteti Shqiptar dhe gjysma do te paguhet nga bleresi. Ne ligj dhe ne VKM parashikohet: tarifa e suksesit, pra tarifa e plote.

22.07 Pra, IFC eshte paguar dy here dhe kjo gje eshte bere pikerisht nepermjet nje VKM e cila ka dale ne kete pike teresisht kunder Ligjit Nr.9889 date 20.03.2008.

22.08 Prokuroria nuk e ka hetuar fare menyren, debatin dhe diskutimet se si ka dale kjo VKM dhe pikerisht lidhur per sa me siper.

A eshte ne te vertete ky rast nje skandal?

A kemi raste te tjera te ngjashme pagesash te dubluara si kjo ne procese te tjara privatizimi?

Cili eshte kompromisi i arritur apo i fshehur per te cilin u be kjo pagese?

Te gjitha keto pyetje nuk kane marre pergjigje nga investigimi i munguar i prokurorise.

Gjykata as qe u ndal qe t'a trajtonte kete problematike si dhe te konstatohte kete shkelje te ligjit si dhe kete abuzim njekohesisht.

23. Rivleresimi i asetëve të OSSH-se në dem të Shtetit Shqiptar dhe në favor të CEZ-it.

23.01 Nuk u vendos një cmim dysheme për këtë procedurë privatizimi.

Në bazë të Ligjit Nr.9889, datë 20.03.2008 "Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të Shoqërisë anonime "OSSH", është Këshilli i Ministrave, i cili përcakton me hollësi, kriteret e përzgjedhjes dhe të vlerësimit të investitorëve strategjikë. Ky ligj, në nenin 8 të tij, përcakton se institucioni përgjegjës për procesin e rivatizimit është Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës.

23.02 Mbi të gjitha, bie në sy fakti se Këshilli i Ministrave, nuk ka vendosur asnjë cmim dysheme, sic është normale në çdo procedurë shitjeje. Përkundrazi, ka parashikuar në Dokumentat e Tenderit një klauzole të quajtur "purchase price adjustment" (rregullimi i cmimit të blerjes). Venia e kësaj klauzole, i ka dhënë të drejtën CEZ-it dhe Komisioneve që më vonë pjesë në këtë procedurë, të efektujnë gjithë procesin e privatizimit, duke ju dhënë të drejtë të zbatojë pa kufi këtë rishikim cmimi, deri në cmenduri. **(E. 21)**

23.03 Duke mos vendosur një cmim minimal nga ku duhet të niste kjo procedurë, me tendencë për të arritur cmimin me të lartë, në fakt CEZ-it ju dha e drejta që ta rishikonte cmimin e blerjes në mënyrë të pakufizuar. Autorët e këtij veprimi, do të justifikohen se vendosja e kësaj klauzole kishte disa arsye:

- a) Se nuk dihej vlera reale e asetëve të OSSH-se;
- b) Se cmimi mund të rivleresohej në favor të Shtetit Shqiptar;

23.04 Sipas Dokumentave të Tenderit, ofertat e investitorëve strategjikë do të përgatiteshin duke u bazuar tek bilanci i vitit 2007 të OSSH-se. **(E. 22)**

23.05 CEZ-i pretendoi se oferta e tij prej 102 milion euro, ishte mbështetur tek bilanci i vitit 2007. Bazuar në këtë, CEZ-i kerkoi një axhustim të cmimit me arsyetimin se, asetet e OSSH-se përgjate vitit 2008 ishin zhvlerësuar dhe se Bilanci i vitit 2007 nuk ishte i saktë. Kjo mënyrë futjeje në privatizim, favorizoi abuzimin me të madh që ka ndodhur ndonjëherë me pronën publike në Shqipëri. Në fakt, Bilanci i Vitit 2008 OSSH-se, flet për një shëndoshje të kompanisë në krahasim me 2007, pasi ka patur mjaft investime të reja në shifrat e disa milione eurove **(E. 23)**

23.06 Cfare ndodhi përgjate vitit 2008 që detyroi palën shqiptare të pranojë se, asetet ishin zhvlerësuar, si dhe se në pamundësi për të ulur cmimin e blerjes për arsye politike, të rrisë vlerën e asetëve në nivelin e pretenduar nga CEZ-i ?

23.07 Cfare ka rezultuar nga hetimi i prokurorisë?

Cili është hetimi i saj?

Cilet persona ka pyetur prokuroria lidhur me këtë çështje?

A mund të jete i vertete pretendimi se prej kohësh KESH, OST dhe OSSH kanë punuar me bilance fallco, sidomos OSSH apo CEZ-Shpërndarje?

A kanë ndikuar këto bilance edhe në vendosjen e një cmimi të energjisë nga ERE shumë më lart se kosto reale, apo të rritjes artificiale të humbjeve, gjë që do të detyronte ERE-n që të vendoste cmime mjaft të ulëta në shitjen e energjisë nga KESH-i tek CEZ-i sipas tarifës së rregulluar?

Nëse bilanci i Vitit 2007 ishte i pasaktë sipas CEZ-it, ku qëndrojnë këto pasaktësi dhe cili është

personi pergjigjes apo personat pergjegjes, qe ky bilanc i pasakte u ofrua si baze e ketij privatizimi?

Si ka mundesi qe gjykata nuk kerkoi nje hetim te hollesishem lidhur me kete akt si dhe pasojat e tij?

23.08 Ne daten 6 Mars 2009, qeveria shqiptare nxorri Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.218, **(E.24)** me ane te te cilit:

a) Kalon ne favor te OSSH-se asetete te financuara nga KESH-i apo kredi afatgjata te marra nga kjo kompani ne shumen 1.1 miliard leke;

b) Ndryshon detyrimet lidhur me investime te kryera nga Banka Boterore ne shumen 2.68 miliarde leke dhe Banka Europiane e Investimeve ne shumen 2.3 miliarde leke, duke i kaluar keto detyrime nga OSSH te KESH-i;

c) Detyrimet afatshkurtra per blerjen dhe transmetimin e energjise qe OSSH i kishte KESH-it dhe OST-se ne vleren 1 miliard leke, u shuan dhe u pasqyruan si rritje kapitali per OSSH;

d) Shuma prej 0.53 miliard lekesh qe i korrespondon pagimit te huave afatgjata, ne vitin 2008, nga KESH, sh.a, u vendos te pasqyrohet si rritje kapitali per OSSH sh.a.

23.09 Shuma totale me ane te se ciles kjo VKM favorizon CEZ-in dhe rendon Buxhetin e Shtetit dhe te KESH-it, eshte 7.61miliard leke, ose e barazvlefshme me 76 milion dollare apo 55 milion euro.

23.10 Si e ka trajtuar prokuroria kete ceshtje?
Cilat jane veprimet e saj?

23.11 Une kam bindjen e plote se, realisht, nese do te kishim nje rishikim te cmimit te blerjes, ai rishikim duhet te ishte ne favor te Shtetit Shqiptar, pasi kemi te bejme me investime te rendesishme ne OSSH pikerisht ne kete periudhe.

23.12 Verifikohet fare lehte nga bilancet e OSSH-se per vitet 2007 **(E. 22)** dhe bilancin e 2008 **(E. 23)**, se perkundrazi, per vitin 2008, kemi nje rritje ne vlere te aseteteve ne shumen 1,393,971,000 leke.

23.13 Me shkresen Nr. 180 te dates 9 Janar 2008 "Komente ne lidhje me Due Diligence dhe opsionet strategjike per privatizimin e shperndarjes se KESH Sh.A" qe ish ministri Genc Ruli i ka derguar z.Angelo Dell' Atti, perfaqesues i IFC ne Tirane, ai shprehet ne piken 1.a. se, detyrimet qe lidhen me kredite, huate te marra nga KESH-i per investime ne asetet e OSSH-se ne momentin e rivatizimit, nuk jane realisht detyrimet e KESH-it, pasi asetet qe do te privatizohen, nuk jane pjese e aseteteve te KESH-it dhe per me teper, kjo vlere eshte arketuar nga Qeveria. **(E. 25)** Me tej ishministri Ruli shprehet ne kete shkrese se: "Ne momentin qe keto investime finalizohen dhe kthehen ne asetete te OSSH-se, duhet te behet transferimi i tyre tek OSSH, duke bere edhe veprimet perkatese ne lidhje me keto asetete" dhe me tej "... Duhet te bihet dakord qe pjesa e detyrimeve qe lidhen me investimet ne proces, te kaloje si detyrim i OSSH-se".

23.14 Perse keto detyrime i kaluan KESH-it?

Perse nderroi papritur mendim ishministri Ruli?

Si ka mundesi qe prokuroria nuk ka ndaluar t'a hetoje deri ne detaje kete veprim?

Sipas ligjit per nderrmarjet tregtare, nje subjekt tregtar, shitet me te gjitha te drejtat dhe

detyrimet e tij. Pse nuk u zbatua kjo gje lidhur me kete rast?
 Perse u zhvesh nga detyrimet e saj OSSH-ja dhe keto iu kaluan KESH-it?
 Mbi cfare baze ligjore u krye ky transferim detyrimesh?
 A ka pergjegjesi qeveria qe ka nxjere nje VKM, nje akt nenligjor te tille te paligjshem, i cili demton rende interesat e Shtetit Shqiptar?
 A e ka hetuar prokuroria nxjerrjen e ketij akti?
 Ne cfare rrethanash dhe kushte u nxorr ai?
 Si ka mundesi qe gjykata nuk u ndal te kerkonte investigim me te plote te ketij fakti, qe edhe keshtu sic eshte paraqitur nga une eshte mese i argumentuar?
 Si ka mundesi qe gjykata nuk konstaton nje dem ekonomik te paster qe i eshte bere vendit nga nje VKM e tille teresisht e jashteligjshme?
 Pse duhet qe detyrimet e OSSH-se t'i merrte persiper shteti yne nepermjet kalimit te tyre tek KESH-i?
 Perse nuk u ndalua prokuroria ne kete problematike dhe t'a hetonte deri ne detaje daljen e kesaj VKM-je abusive?
 Kush jane pergjegjesit per nje veprim te tille?
 Si mundet gjykata qe te mos e konstatoje nje abuzim te tille?

- 23.15** Kjo teme nuk ka kaluar pa debate ne mbledhjet e qeverise pasi kemi z.Bode qe e ka permendur kete gje dhe pikerisht ne mbledhjen e qeverise te dates 17.09.2008.
- 23.16** Gjate shqyrtimit te procesverbalit te Mbledhjes se Keshillit te Ministrave te dates 17 Shtator 2008 (pikerisht vetem 12 dite para hapjes se ofertave), vlen per t'u permendur prononcimi i Ministrit te Financave Ridvan Bode, i cili theksoi se ka tendenca per te zgjeruar jo vetem garen, por, edhe risqet, qe parashikohen nga procesi i privatizimit. Ne prononcimin e tij te pare ne kete mbledhje, ish ministri Bode ka kerkuar sqarime nga ish ministri Ruli. **(E. 2)**
- 23.17** Ministri Bode ka vazhduar duke theksuar se: "Per me teper qe ngrihen pretendime, qe pasi ta privatizojme, pasi te paguajme parate, ai qe e privatizon, ka te drejte te beje rivleresimin e pronave, nese pronat e kane apo nuk e kane kete vlere, dhe pas kesaj kane te drejte qe shteti tua ktheje ne masen 100 % te gjitha ato gabime qe mund te behen ne vleresimet tona ose te atyre qe mund te nxjerre ai gabim". **(E. 2)**
- 23.18** Pra eshte e qarte nga ky pohim, se pergjate ketij procesi ka patur negocime dhe dijeni te plote per ate qe do fitoje, si dhe per veprimet e tij te mevonshme. Nuk ka si te shpjegohet ndryshe qe, pasi CEZ-i u shpall fitues, ndodhi pikerisht kjo qe parashitroi ishministri Bode ne kete mbledhje qeverie, ku CEZ-i kerkoi rivleresim te asetëve.
- 23.19** Cfare konkluzioni ka nxjerre prokuroria dhe gjykata lidhur persa me siper?
- 23.20** Po ne kete takim, ish ministri Ruli eshte shprehur se: "Po flas nje here per OSSH-ne, e cila nuk rezulton me humbje, se eshte kompani e krijuar kete vit,...,borxhet e OSSH-se ja kemi kaluar KESH-it ... etj".
 Si mundet qe nje prokurori dhe gjykate te mos ndalet pikerisht ne kete deklarate te ish ministrit Ruli?
 Kjo thenie behet ne mbledhjen e qeverise ne shtator 2008, ndersa lidhur me kalimin e ketyre borxheve, ish ministri Ruli ka folur, MEDEMEK PER HERE TE PARE ne shkurt 2009 dhe me pas ka

iniciuar VKM e famshme ne 6 mars 2009 per kalimin e ketyre borxheve.

Ne shkurt 2009 ishministri Ruli daklaroi se, kane dale disa probleme se fundi, lidhur me zhvleresimin e asetëve te OSSH-se dhe propozoi qe, ne pamundesi te uljes se cmimit te blerjes nga CEZ-i te rritej vlere e asetëve te OSSH-se pikerisht nepermjet ketij veprimi.

- 23.21** Analizuar kete thenie, ne mesojme se, OSSH nuk paska qene me humbje dhe se borxhet, pra kalimi i detyrimeve nga OSSH tek KESH-I, ka qene i paracaktuar qe perpara se te zhvillohej faza e dyte e tenderit qe ishte hapja e ofertave financiare ne 29.09.2008.
- 23.22** Perse nuk u ndryshuan dokumentat e tenderit dhe te shtyhej faza finale e tenderit, por ky kalim i parashikuar detyrimesh u la per ne mars 2009?
- 23.23** A eshte shprehur nje gje e tille ne mbledhjen e qeverise kur mori vendimin per kalimin e detyrimeve?
- 23.24** Nga ky prononcim, mesojme vendimi qe ishte marre per t'i kaluar borxhet e OSSH-se te KESH-i, perpara se te hapeshin ofertat.
- 23.25** Ne kete prononcim te tij, ish ministri Ruli bie ne kundertshtim me qendrimet e tij te Janarit 2008 **(E.10)**, se detyrimet e OSSH-se duhet ti kalojne Bleresit. Po keshtu hedh poshte justifikimin e bere ne fillim te vitit 2009, se borxhi i OSSH-se duhet ti kaloje KESH-it, per arsye se, pas hapjes se ofertave ne 29 Shtator 2008, paskan ndodhur disa ngjarje qe kane ulur vleren e asetëve te OSSH-se.
- 23.26** Shihet qarte se, vendimi per te konsideruar zhvleresimin e asetëve, si dhe delegimin e borxheve te OSSH-se tek KESH-i, eshte marre de facto perpara dates se hapjes se ofertave dhe duhet te kene qene ngjarje te tjera ndermjet Janarit 2008 dhe Shtatorit 2008 ato te cilat kane ndikuar ne marrjen e nje vendimi te tille.
- 23.27** Pse nuk arriti organi i hetimit qe te zbulonte se, si eshte negociuar kjo pike qe i kushtoi 70 milione USD buxhetit te shtetit?
Cilet persona jane perfshire ne kete negociim, pasi komisioni i negociimit nuk ishte krijuar fare ne shtator 2008?
- 23.28** De jure, nje vendim i tille eshte marre ne daten 6 Mars 2009 me Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr 218. **(E. 24)**
- 23.29** Ne asnje nga takimet negociatore, perpara dates 26 Shkurt 2009, nuk eshte permendur apo pretenduar nga pala ceke, per nje zhvleresim te asetëve te ndodhur pas dates 29 Shtator 2008, date ne te cilen u hapen ofertat.
- 23.30** Ne takimin e perbashket ndermjet Komisionit te Konsulences dhe Transparences dhe Komisionit te Negocimit per privatizimin e OSSH-se te mbajtur ne daten 26 Shkurt 2009 **(E. 47)**, ne prani edhe te Keshilltares se Kryeministrit Suzana Guxholli, ish ministri Ruli i ben te ditur pjesemarrësve ne takim, se gjate negociatave te fundit, kane dale disa probleme ne lidhje me vleren neto te asetëve (NAV) te OSSH-se.
- 23.31** Duke shqyrtuar procesverbalet e takimeve per negociatat mes paleve, qe fillojne qe nga datat 18 dhe 19 Nentor 2008 **(E. 26)**, duke vazhduar ne datat 24 Nentor 2008 **(E. 27)**, 4 Dhjetor 2008

(E. 28), 10 Dhjetor 2008 (E. 29), 11 Dhjetor 2008 (E. 30), 7 Janar 2009 (E. 31) dhe 8 Janar 2009 (E. 32), nuk rezulton te jete ngritur apo diskutuar nje problem i tille nga palet.

- 23.32** Per kete arsye, ngrihet pyetja: Ne cfare takimesh negociatore kane dale dhe jane ngritur keto probleme qe ngre Z. Ruli?
Cfare ka arritur te zbuloje prokuroria?
Cili eshte qendrimi i saj lidhur me kete pike?
Kush kane qene negociatoret qe ne nuk i dime?
Ku dhe kur jane zhvilluar keto negociata?
Pse gjykata nuk arrin te konstatoje nje mungese te plote te hetimeve ne kete rast?
- 23.33** Ishministri Ruli ka parashtruar se, ky zhvleresim eshte bere per shkak se cmimi i blerjes eshte perlllogaritur mbi bilancin e vitit 2007, i cili rezulton i ndryshem nga Bilanci i vitit 2008, me nje renie te vleres se asetëve. Pikerisht, per te mos ulur cmimin e blerjes, meqenese perfaqeson nje simbolike politike, sipas ishministrit Ruli, rruga me e mire do te ishte sjellja e vleres se asetëve ne vleren qe i referohet cmimit te blerjes.
- 23.34** Eshte e cuditshme qe, ishministri Ruli i referohet Bilancit te vitit 2008, ne shkurt te vitit 2008, ne nje kohe qe zyrtarisht, Bilanci i vitit 2008 eshte miratuar nga Asambleja e Aksionereve te CEZ-Shperndarje vetem ne daten 18 Qershor 2010. (E. 33)
- 23.35** Cfare mendon prokuroria lidhur me kete gje?
Si u arrit te nxirrej nje VKM bazuar mbi nje bilanc te pamiratur ligjerisht?
Po gjykata si mundi t'a neglizhoje kete fakt?
- 23.36** Po ne kete takim, perfaqesuesi i IFC z.Tomas Sipos, shpjegoi hollesisht se ndryshimi negativ i vleres se asetëve, ka ardhur si pasoje e humbjeve operationale te shkaktuara nga adoptimi i cmimit per blerjen e energjise nga OSSH prej KESH-it.
- 23.37** Nga ballafaqimi i bilanceve te OSSH-se per vitet 2007, 2008, 2008 i riparaqitur, dhe 2009, rezulton qe, jo vetem nuk kemi ulje te vleres neto te asetëve, por kemi rritje te tyre.
- 24. Favorizimi i bleresit te OSSH-se (CEZ-it) me ane te politikave te ERE-s lidhur me cmimin e energjise.**
- 24.01** Pavaresisht se OSSH ishte e patestuar me Modelin e Ri te Tregut, (gje qe do te thote perseri qe ky privatizim ishte i nxituar), perseri jam i mendimit se CEZ-i, si te gjithe investoret e tjere strategjike, kishte mundesi te llogariste mjaft mire oferten e vete, ne baze te tarifave te vendosura nga ERE me Vendimin Nr.75, date 26.06.2008, i cili i shrinte efektet e tij nga data i Janar 2008 deri ne 28 Shkurt 2009. (E. 48)
- 24.02** Cmimi i percaktuar nga ERE ne kete vendim ka qene 1.61 leke/kvh dhe ishte nje cmim i cili favorizonte OSSH-ne dhe disfavorizonte KESH-in, ne nje kohe qe cmimi i importit te energjise per kete peridudhe ishte mesatarisht 8 leke/kvh.

- 24.03** Ne mbledhjen e Keshillit te Ministrave te dates 17 Shtator 2009, pak perpara hapjes se ofertave, eshte diskutuar edhe problemi i ketij cmimi. Ketu del se cmimi i vendosur nga ERE ishte i afert me koston te cilen KESH-i e prodhonte, por shume i ulet po ta krahasosh me cmimin me te cilin KESH-i e blente nga importi.
- 24.04** Te ben pershtypje gjate ketij takimi, prononcimi i ish ministrit Ruli i cili thote se: "Fitimi i tij (pra i investitorit strategjik), eshte 2 % dhe i eshte dhene qe tani ne kontrate".
- 24.05** Nga kjo thenie, nxirret konkluzioni se, fituesi ishte paracaktuar, kontrata ishte bere faktikisht, cmimi ishte paracaktuar, po ashtu edhe norma e fitimit, nje norme e cila eshte ne kundërshtim me Dokumentat e Tenderit, ku percaktohej ne masen 1 %.
- 24.06** Pra CEZ-i e ka ditur fare mire dhe ka llogaritur ne menyre te sakte oferten e tij duke u mbeshtetur ne Vendimin e ERE-s (**E. 48**), duke marre per baze cmimin 1.61 leke/keh. Ky cmim nuk ka ndryshuar gjate gjithë vitit 2008 dhe 2009. Pra, nuk ka ndikuar aspak negativisht ne zhvleresimin e vleres neto te asetëve, adoptimi i cmimit te energjise sipas Modelit te Ri te Tregut.
- 24.07** Prokuroria nuk e ka trajtuar fare kete ceshtje dhe gjykata as qe mori mundimin qe te konstatoje dhe vleresonte edhe ato qe jane te shkruara nga vete qeveria ne mbledhjet e saj.
- 25. Ndryshimi dhe miratimi i nivelit te borxhit te keq nga 4% ne 14%.**
- 25.01** Ajo cfare konstatojme nuk eshte adoptimi i cmimit, por favorizimi ne menyre te jashteligjshme, qe, i eshte bere CEZ-it, me njohjen e nivelit te Borxhit te Keq ne nivelin 14%.
- 25.02** Sipas Dokumentave te Tenderit, cdo investitor strategjik, duhet te merrte parasysh respektimin e nivelit te borxhit te keq ne nivelin 4 %, ashtu sic ishte percaktuar ne Deklaraten Rregullatore te miratuar me Vendimin e ERE Nr.107, date 9 Shtator 2008. (**E. 35**)
- 25.03** Pas hapjes se ofertave, ne negociimet midis CEZ-it (te shpallur fitues) dhe Grupit te Negocimit, u perfshi, ne kundërshtim me dokumentat e tenderit, edhe niveli i Borxhit te Keq. Referuar pikes 5.2 te VKM Nr. 835, date 11 Qershor 2008 (E. 5), CEZ-i ka patur te drejte vetem te trajtoje justifikimin e borxhit te keq, gje qe do te thote se, palet duhet te binin dakord vetem me ate se, kush do te quhej borxhi i keq.
Kurrresi ne Dokumentat e Tenderit nuk i eshte dhene mundesi CEZ-it, qe te diskutoje apo propozoje nje nivel borxhi te keq, te ndryshem nga ai i miratuar nga ERE.
- 25.04** Ne oferten e tij dhe me pas, CEZ-i e ka shkelur kete parashikim, duke e vene ne diskutim kete nivel, pra duke mos plotesuar kriteret minimale teknike.
- 25.05** Negocimi i kushteve minimale teknike te vendosura ne tender, perben shkelje ndaj vete VKM Nr. 835, dt 11 .06.2008 si dhe nenit 21 te Ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006" Per prokurimin publik". (**E. 37**)
Keshtu ne nenin 51 te ketij ligji percaktohet se:"Ndalimi i modifikimit te ofertave:

- a) Pas paraqitjes se ofertës nuk duhet të kryhet asnjë bisedim ndërmjet autoritetit kontraktor dhe ofertuesit për ofertën, në përputhje me pikën 1 të nenit 53 të këtij ligji.
- b) Një ofertuesi, si kusht për shpalljen e tij fitues, nuk duhet t'i kërkojë që të ndermarrë përgjegjësi të papercaktuara në dokumentet e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdo mënyre ofertën."
- 25.05** Ka qenë e papranueshme, dhe teresisht e jashtëligjshme që, është negociuar me CEZ-in lidhur me këtto pika, pasi kjo shoqëri ishte shpallur fituese me ofertën e paraqitur.
- 25.06** Ndryshimi i nivelit të borxhit të Keq nga 4 % në 14 %, ka sjellë si pasoje që, kompania CEZ, të favorizohet me një kompensim vjetor prej afërsisht 70 milionë dollarë në vit, vlerë kjo e cila pasqyrohet si dem në Buxhetin e Shtetit.
- 25.07** Duke njohur këtë nivel të borxhit të keq, ERE u detyrua gjithashtu që në bazë të ligjit, të merrte parasysh këtë borxh edhe në koston e cmimit të energjisë elektrike.
- 25.08** Kostoja e borxhit të keq është afërsisht 7 milionë dollarë për çdo 1 % rritje. Për 10 % më tepër që ju njoh në mënyrë të paligjshme ky borxh, CEZ-i u favorizua me 70 milionë USD në vit, të cilat **kane dalë nga buxheti i shtetit shqiptar.**
- 25.09** Me kontratë, ju kompensua CEZ-it një nivel prej 4 %, i cili në fakt më vonë u miratua nga ERE akoma më i lartë pothuaj në shifrën e 20%. Këtë dem të përvitshëm, i shtohet edhe zhvlerësimi absurd i aseteve të pretenduar nga CEZ-i dhe për të cilën qeveria e atëhershme nxorri VKM Nr.218, datë 6 Mars 2009, në bazë të së cilës u favorizua CEZ-i me rreth 70 milionë USD të tjera që njëkohësisht u pasqyruan humbje në Buxhetin e Shtetit. Pra, sipas një llogarie të thjeshtë, vetëm me këtto dy favorizime, CEZ-i u favorizua me 140 milionë USD që në vitin e parë, për një paketë aksionesh të cilat ai i bleu për 102 milionë EURO.
- 25.10** Është pikërisht ky leshim, ndryshimi i paligjshëm dhe njohja e nivelit të borxhit në 14% që kon në Shumen 70 milionë dollarë dhe është pikërisht kjo shumë që zbritet si provigjionim nga llogaritë e arketueshme dhe për të cilat u kërkua kompensimi i vlerës së aseteve nga ishministri Ruli.
- 25.11** Pra, përveçse ju bë një favor CEZ-it, duke ju njohur një nivel më i lartë borxhi sesa ai i njohur nga ERE dhe nga Dokumentat e Tenderit, iu bë edhe një favor i dytë i kushtezuar nga ai i pari, ai i rritje së vlerës së aseteve, i cili në të vërtetë e uli cmimin e blerjes të OSSH me 70 milionë USD apo 55 milionë euro që në momentin e parë. Në kuadrin e një viti, kjo ulje vazhonte e siguruar me 70 milionë USD të tjera apo 55 milionë euro gjë që e konte favorizimin e paligjshëm të CEZ-it, dhe demin ndaj buxhetit të shtetit brenda vitit, në 110 milionë euro. **(E. 24)**
- 25.12** Ky dem i është shkaktuar Buxhetit të Shtetit nga VKM Nr.218, datë 6 Mars 2009, pikërisht një javë para firmosjes së Marrëveshjes për Blerjen e Aksioneve.
- 25.13** Këtto ndryshime u bënë edhe pse në takimet midis paleve, si ai i 4 Dhjetorit 2008 **(E. 28)** përfaqësuesit e ERE-s, shprehën shqetësimin me faktin se, propozimet e paraqitura përbejnë ndryshime thelbësore të kriterëve fillestare.

- 25.14** Perse prokuroria nuk ka bere asnje hetim lidhur me kete ceshtje?
Perse nuk jane pyetur perfaqesuesit e ERE-s si dhe te komisionit te negociimit?
- 25.15** Fillimisht vete ERE e ka konstatuar kete shkelje por me vone ajo u detyrua qe te nderronte qendrim.
Perse nuk u investigua se cfare e detyroi ERE-n, qe te leshonte pe lidhur me nje veprim te tille?
- 25.16** Perse gjykata nuk arrin t'a konstatoje kete shkelje te madhe ligjore dhe me dem teper te larte per ekonomine e vendit?

26. Nuk eshte ruajtur sipas ligjit ne protokoll dosja e privatizimit te OSSH-se.

- 26.01** Nuk eshte zbatuar neni 42, pika 3 e ligjit per prokurimin publik lidhur me mbajtjen e protokollit te kesaj procedure. As ne ministrine pergjegjese per kete proces, as ne OSHEE dhe as ne Kryeministri nuk eshte gjetur asnje dosje e protokolluar ne lidhje me kete procedure.
- 26.02** Kjo ceshtje nuk eshte trajtuar fare nga prokuroria, edhe pse pasojat jane teper te renda.
- 26.03** Nese do te hetohej si duhet, prokuroria do te na kishte ofruar edhe shkakun pse nuk eshte ruajtur e plote kjo dosje ne protokoll, por edhe shkaktaret, urdheruesit, perfituesit dhe ekzekutuesit.
Gjithashtu gjykata as qe i vuri rendesi ketij fakti.

27. Realizimi i nje procesi te paligjshem negociimi i cili rrenoi te gjitha integritetin e tenderit te hapur.

- 27.01** Negocimi per pikat e percaktuara si kushte minimale teknike te detyrueshme, ka prishur krejtesisht integritetin e ketij tenderi te hapur dhe de facto, pas dates 29 Shtator 2008, palet kane zhilluar nje procedure tenderi me negociim ku nuk eshte rnarre parasysh asnje nga kriteret e KM Nr. 835, dt. 11.06.2008 "Per percaktimin e madhesis se pakete se aksioneve te kapitalit, te shoqerise anonime "Operatori i Sistemit te Shperndarjes", qe u ofrohet investitoreve strategjike" si dhe percaktirnet e ligjit per prokurimin publik.
- 27.02** Edhe pse prokuroria ka pasur te beje me nje trajtim te hollesishem, qe une i kam bere kesaj pike, ajo perseri e ka lene jashte trajtimit te saj se, perse ndodhi nje shkelje e tille ligjore, kush jane pergjegjesit, urdheruesit dhe ekzekutuesit, cfare demesh pesoi shteti yne etj.

28. Parregullsi ligjore ne ngritjen e komisioneve.

28.01 Ne Kreun VII, pika 1 te VKM Nr.329, date 12.7.1999 "Per procedurat e tenderit per zgjedhjen e investitoreve strategjike dhe per transferimin e aksioneve te zoteruara nga shteti ne shoqerite tregtare te sektoreve me rendesi te vecante", **(E. 40)** percaktohet se :

"Komisioni i vleresimit te ofertave do te jete Komiteti i Konsulences dhe i Transparences, ne perputhje me vendimin e Keshillit te Ministrave nr.621, date 25. 9.1998, si dhe nje perfaqesues i Agjencise Kombetare te Privatizimit (AKP).

28.02 Ne piken 3 te VKM Nr.621, date 25.9.1998 "Per krijimin e komitetit te konsulences dhe te transparences per privatizimin e sektoreve me rendesi te vecante te ekonomise ", **(E. 41)** percaktohet se: "Komiteti perbehet nga 13 anetare, dy perfaqesues nga Ministria e Ekonomis Publike dhe Privatizimit nje perfaqesues nga Ministria e Financave, nje perfaqesues nga Ministria e Drejtesise, dy perfaqesues nga organet perkatese, qe pergjigjen per administrimin e prones shteterore, te cilet kane ne vartesi dhe gjashte anetare te tjere, qe do te caktohen ndermjet konsulentëve financiare, ligjor dhe te marketingut, te seleksionuar ne nivel nderkombetar nepermjet procedurave konkurruese te njohura nga Banka Boterore".

28.03 Komisioni i Vleresimit te Ofertave per privatizimin e OSSH i ngritur me Urdherin Nr 329, date 13.05.2008 (E 42), ka patur ne perberjen e tij 5 perfaqesues te METE-s dhe 4 perfaqesues te IFC, kjo ne kundershtim te hapur me dy VKM-te e lartpermendura **(E. 40 dhe E. 41)**

28.04 Nuk kemi asnje investigim te prokurorise persa me siper, si dhe asnje trajtim nga gjykata, e cila ne kete rast do t'i duhej vetem qe te bente nje konstatim.

28.05 Duke qene se ishministri Genc Ruli, nuk e kishte deleguar detyren e tij si Kryetar i Komitetit te Konsulences dhe Transparences, ai duhet te ishte Kryetar i Komisionit te Vleresimit te Ofertave.

28.06 Pikerisht menyra joligjore e ngritjes se ketij Komisioni, ka ndikuar qe, ne hapin e pare qe ka bere ky komision, i cili ne te njejten dite qe eshte ngritur, ka miratuar Dokumentet e Tenderit per fazen parakualifikues. **(E. 43)**

28.07 Ngritja e ketij Komisioni dhe funksionimi i tij, bie ne kundershtim me VKM Nr.1, date 10 Janar 2007 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" **(E. 44)** dhe konkretisht me pikat 1/a dhe 2/<; te saj,

28.08 Ne keto pika parashikohet se, duhet te sigurohet nje ndarje e qarte nderrnjete detyrave te zyrtareve te perfshire ne hartimin e dokumentave te tenderit dhe atyre te perfshire ne perzgjedhjen e fituesve. Pra kjo VKM percakton qarte se, KVO eshte pergjegjese vetem per shqyrtimin e ofertave.

28.09 Ligjet Nr.8306, date 14.03.1998 dhe Nr.9889, date 20.03.2008, autorizojne Keshillin e Ministrave, per nxjerrjen e kritereve perzgjedhese, qe nenkupton edhe miratimin e dokumentave te tenderit.

- 29. Komisioni i Vleresimit te Ofertave per Privatizimin e OSSH-se, delegon ne menyre te jashteligjshme kompetencat e tij tek Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve Tregtare prane METE-s si edhe tek konsulentet e IFC-se.**
- 29.01** Komisioni i Vleresimit te Ofertave per Privatizimin e OSSH-se eshte ngritur me Urdhrin e ishministrit Ruli nr.339 dt 13.05.2008. Si shpjegohet qe ky komision po ne dt.13.05.2008 me ane te Vendimit nr.1 te tij miraton dokumentat e tenderit per fazen e parakualifikimit (te pergatitur nga konsulentet e IFC-se) dhe delegon kompetencat e tij tek Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve Tregtare prane METE-s si edhe tek konsulentet e IFC-se.
- 29.02** Ky Komision eshte ngritur me ane te VKM nr.487, dt 16.04.2008 dhe atje nuk parashikohet asnje kompetence e tille, ku ky komision, mund t'i delegeje detyrat e tij, apo te kete tager urdherues karshi subjekteve te tjera jashte perberjes se tij.
- 29.03** Perseri nuk kemi as hetime nga prokuroria dhe as konstatim nga gjykata lidhur persa me siper.
- 30. Duhej konfiskuar garancia e ofertes se CEZ-it.**
- 30.01** Nuk u konfiskua garancia e ofertes se CEZ-it, pasi kaloi afat 30 ditor pas njoftimit te fituesit dhe marreveshja nuk ishte nenshkruar nga CEZ-i.
- 30.02** Ne Kreun IV, pika a te VKM Nr.329, date 12.07.1999, **(E. 40)** percaktohet se: ofertuesi duhet te paraqese nje garanci bankare ne favor te METE-s ne vleren 20% te vleres se aksioneve te ofruara ne tender.
- 30.03** Bazuar ne Urdherin Nr.319, date 6 Maj 2008 te Ministrit te METE-s, Genc Ruli "Per zmadhimin e kapitalit te OSSH", kjo garanci bankare duhet te ishte minimalisht ne vleren prej 40 milion dollare.
- 30.04** Ne daten 13.08.2008 Keshilli i Ministrave ka nxjerre VKM nr.1170 me ane te te cilit vendos se, garancia e ofertes per kete procedure privatizimi do te jete 5 milione euro **(E. 46)**. Pra me kete VKM eshte favorizuar CEZ-i, cili do te duhej t'a paguante garancine e ofertes ne rast se: ai do te deshtonte te nenshkruante brenda 30 diteve kalendarike, pas njoftimit te fituesit, marreveshjen e blerjes se aksioneve, kryesisht ne formen e paraqitur ne oferten e tij.
- 30.05** Kjo eshte nje shkelje e paster ligjore.
- 30.06** Ne qofte se kjo garanci oferte do te ishte 40 milione dollare, CEZ-i do te ishte me i permbajtur ne lojrat e tij, lidhur me nenshkrimin e marreveshjes.
- 30.07** Pse nuk u zbatua ligji dhe cili eshte argumentimi i prokurorise si dhe trajtimi qe i ka bere kesaj ceshtjeje?
- 30.08** Perse gjykata nuk arrin te konstatoje edhe ne kete rast nje shkelje te paster ligjore?

31. Ministri Ruli duhej te terhiqej nga procesi i privatizimit

- 31.01** Prej ishministrit Ruli nuk u ushtrua e drejta ligjore, qe i jepte VKM nr.487, dt.16.04.2008 ne piken 6 te saj, ku si minister i METE-s, me nje urdher te motivuar ligjerisht, ai kishte te drejte ne cdo rast, te terhiqej nga procesi i shitjes apo ta nderpriste ate.
- 31.02** Edhe historia me pas e ketij privatizimi te pasukesshem e vertetoi se, mosmarrja e ketij hapi, i kushtoi shume rende Shtetit Shqiptar.

32. Shkeljet e konstatuara ne lidhje me planin e biznesit te paraqitur nga CEZ-i.

- 32.01** Ne piken 3.5 te VKM Nr. 835, date 11.06.2008 percaktohet se: "Plani i biznesit do te pershkruaje planet strategjike, operacionale dhe financiare te Ofertuesit per periudhen e tanishme dhe 5 vitet vijuese te OSSH-se".
- 32.02** Nese perzgjidhet si nje ofertues fitues, Ofertuesi do te beje perpjekjet e tij me te mira, per te zbatuar Planin e tij te Biznesit, sic eshte dorezuar".
- 32.03** Kriteret e Planit te Biznesit kane qene teper siperfaqesore dhe te paspecifikuara. Kjo ka bere qe ofertuesit te ishin te lire te paraqesnin nje Plan Biznesi me pershkrime te pergjithshme, pa specifikuar sidomos vleren, qe do te investonin ne 5 vitet vijuese.
Ky kriter ka qene shume i domosdoshem per t'u pernbushur nga ofertuesit, pasi ne rast te shpalljes fitues, ofertuesi ishte i detyruar, qe te zbatonte ne te ardhmen, Planin e Biznesit qe kishte paraqitur ne oferte,
- 32.04** Ne fakt kjo eshte pikerisht ajo qe ka ndodhur me ofertat e CEZ-it dhe ENEL-it.
Pavec faktit qe Plani i Biznesit te paraqitur nga CEZ-i ishte disi me i detajuar, (ne fakt pjesa me e madhe e Planit, pasqyronte nje pershkrim te gjendjes se OSSH-se, ne momentin e privatizimit), te dyja ofertat cilesoheshin si "Plane Biznesi Paraprake", pra joperfundirntare.
Ne kete kuptim, fituesi nuk ishte i detyruar, qe te kryente investime sipas ofertes se bere ne tender.
- 32.05** Ne piken 3.1.1, paragrafi (ix), te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr.835, date 11.06.2008, percaktohet se operatoret duhet te paraqisnin ne dokumentat e ofertes edhe Planin e Biznesit.
- 32.06** Ne Raportin e Vleresimit te Ofertave rezulton se, Komisioni i Vleresimit te Ofertave eshte shprehur se oferta e ENEL-it, nuk e kishte Planin e Biznesit, ndersa oferta e paraqitur nga CEZ-i nuk kishte asnje parregullsi.
- 32.07** Nga dokumentacioni, qe ka analizuar Komisioni i Vleresirnit te Ofertave, rezulton se, CEZ-i ka paraqitur ne oferten e tij nje dokument te titulluar "Plani Paraprak i Biznesit per vitet 2009-2014".
- 32.08** Pra, gjeja e pare qe bie ne sy, eshte fakti qe kjo shoqeri nuk ka paraqitur nje plan biznesi, por nje plan paraprak biznesi.

- 32.09** Ne faqen 18 te ketij dokumenti qe titullohet "Formati i propozuar dhe permbajtja e planit te biznesit qe do te pergatitet gjate 6 muajve te pare te veprimit", CEZ-i shprehet si me poshte: "Synimi i CEZ-it eshte te propozoje nje format dhe strukture te planit te biznesit qe do te perditesohet cdo 6 muaj gjate 2 vjeteve te para te veprimit dhe me pas ne baza vjetore.
- 32.10** Megjithate, formati aktual eshte per t'u konsideruar si nje draft i pare i nivelit te larte i struktures se planit te biznesit. Bazuar ne draftin e tij te pare, CEZ-i do te deshironte te kryente bisedime me METE-n dhe palet e tjera te interesuar ne lidhje me strukturen ekzakte dhe permbajtjen e planit te biznesit."
- 32.11** Pranimi i ketij plani biznesi, i hoqi te drejten pales shqiptare, ne zgjidhjet e mevonshme te mosmarreshjeve me CEZ-in, te ngritjes te pretendimeve per mos kryerje investimesh nga CEZ-i, perderisa ato ishin te papranishme ne plan-biznesin fillestar te lidhur ne kontrate, sipas asaj qe u paraqit ne oferten e CEZ-it.
- 32.12** Si ka mundesi qe prokuroria dhe gjykata nuk arrijne te vleresojne nje fakt te tille?

Kapitulli III

33. Personat e kallezuar nga une dhe objekti i kallezimit.

33.01 Duke konstatuar keto problematika dhe shkelje ligjore, une bera verifikimet e duhura dhe pashe plotesisht te arsyeshme, qe te kallezohet shtetasit e meposhtem, si personat pergjegjes, per veprat penale te mesiperme:

- 1. Sali Berisha**, ish kryeminister i Republikes se Shqiperise;
- 2. Nuel Kalaj**, sekser;
- 3. Genc Ruli**, ish minister i ekonomise, Tregtise dhe Energjise dhe Kryetar i Komitetit te Konsulences dhe Transparences prane METE-s;
- 4. Mimoza Vokshi**, anetare e Grupit te Negociimit dhe ish drejtoare ne METE;
- 5. Suzana Guxholli**, ish keshilltare e Kryeministrit Berisha;
- 6. Neritan Alibali**, ish z/minister i METE-s dhe Kryetar i Grupit te Negociimit me CEZ-in si dhe kryetar i Komisionit te Vleresimit te Ofertave;
- 7. Alfred Rushaj**, ish z/minister i financave dhe anetar i grupit te negociimit me CEZ-in;
- 8. Fatjon Tugu**, anetar i grupit te negociimit me CEZ-in dhe anetar i komisionit te vleresimit te ofertave;
- 9. Sherefedin Shehu**, anetar i grupit te negociimit me CEZ-in;
- 10. Asllan Sherra**, anetar i grupit te negociimit me CEZ-in;
- 11. Viktor Gumi**, anetar i grupit te negociimit me CEZ-in;

12. **Miran Kopani**, anetar i grupit te negociimit me CEZ-in;
13. **Bujar Nepravishta**, anetar i grupit te negociimit me CEZ-in;
14. **Durim Kraja**, ish sekretar i pergjithshem i METE-s dhe anetar i grupit te negociimit me CEZ-in;
15. **Engjell Qorlaze**, anetar i komisionit te vleresimit te ofertave;
16. **Vasil Pano**, anetar i komisionit te vleresimit te ofertave.

33.02 Objekti i kallezimit tim ishte si me poshte:

Kallezim per veprat penale te "Shperdorirrit te detyres", "Shkelje te barazise se pjesemarresve ne tendera apo ankande publike", "Mashtrimit", "Ushtrimit te ndikimit te paligjshem ndaj personave qe ushtrojne funksione publike", "Pastrimit te produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale", vepra penale te parashikuara nga nenet 143, 245/1, 248, 258 dhe 287 te Kodit Penal.

- 33.03** Sic shihet, prokuroria nuk ka pyetur pothuaj asnje nga keta persona, por ne dy vjet eshte mjaftuar vetem me pyetjen e disa personave (kater ose pese) prej tyre te cilet jane te nje rendesie jo te dores se pare, lidhur me kete ceshtje. Gjykata edhe pse urdheroi te beheshin hetime te plota dhe te hollesishme, ajo perseri nuk e konstatoi si mangesi as pyetjen e ketyre personave, qe jane kallezuar penalisht prej meje dhe qe kane pasur nje rol kryesor ne kete procedure privatizimi.

Kapitulli IV

34. Provat e reja te ofruara nga une ne kete proces

- 34.01** Pergjate kryerjes se detyres sime si ekspert ligjor i OSHEE-se, kam konstatuar ne shkresa, emaile dhe dokumenta zyrtare, mjaft fakte dhe prova, qe me shtyne te investigoj procesin shume te perfolur te privatizimit te OSSH-se ne vitet 2008-2009.
- 34.02** Si pikenisje ka sherbyer leximi i disa qindra e-maileve te ofruara nga vete CEZ-Group, nepermjet studios avokatore Clifford Chance, ne vitin 2014, si suport qe ata do te na jepnin ne ne lidhje me mbrojtjen e interesave te kompanise ndaj pretendimeve te bera nga kompania DIA-Dega Shqiperi kishte ngritur ne Arbitrazhin e Vienes.
- 34.03** E-maili i pare qe me beri te ve ne dyshim procedures e privatizimit te OSSH-se ishte ai i dates 7 shtator 2009, ora 1:51 i nisur nga Nuel Kalaj ne drejtim te Martin Roman, Drejtor i CEZ-Group. E-maili eshte me subjekt: Zhvillimet ne OSSH, dhe nisur nga adresa: nuelkalaj@gmail.com. **(E- 02)**
- 34.04** Ne paragrafin e peste te ketij e-maili thuhet: " ... duke folur sinqerisht, mua personalisht me vjen keq te shoh se, pas nje pune kater vjecare per CEZ-in, duke luftuar qe, nje kompani

serioze dhe e sukseshme si CEZ-i, te futet ne sektorin energjetik ne Shqiperi, probleme te ngjashme, do te shkatërrojne frutin e nje pune te madhe, qe une dhe z.Petran, kemi bere per muaj e muaj dhe negocime pas negocimesh, per te arritur nje privatizim te suksesshem te OSSH-se".

- 34.05** Ky e-mail, me vuri ne dyshim pikerisht kohen dhe korrektine e menyres se privatizimit te OSSH-se, pasi sic dihet boterisht, ky privatizim ka filluar ne vitin 2008, me ane te procedures se tenderit te hapur.
- 34.06** Deklarimi i mesiperm ne e-mailin e 7 shtatorit 2009, me beri te hedh ne dyshim kete procedure, e cila mund te kishte filluar paraprakisht mjaft vite me pare, se sa ishte deklaruar zyrtarisht dhe te ishte e parapergatitur pikerisht per t'u fituar nga CEZ-Group.
- 34.07** Permendja e emrit Petran ne kete e-mail e perforcoi kete dyshim, pasi une shume shpejt verifikova se, ne kete process eshte perfshire pikerisht ky person me emrin Petran, si anetar i grupit te negocimit te ofruar nga CEZ-Group.
- 34.08** Pra, kemi nje person me emrin Petran, qe eshte i perfshire zyrtarisht ne vitet 2008-9 ne kete process, por edhe jozyrtarisht, vite me perpara sipas Nuel Kalajt.
- 34.09** Duke u interesuar per personin e Nuel Kalajt, une kam marre informacion me te detajuar me shkrim per kete person nga shtetasi kosovar Beg Rizaj, i cili me dergoi disa te dhena jozyrtare, por me sa duket te mbledhura nga ndonje sherbim inteligjent. **(E. 001)**
- 34.10** Ne kete informacion jepen keto te dhena:
- a.** Ne fund te vitit 2004, Hamza Merxhani me banim ne Prage dhe pjese e CEZ-Group ka tentuar te fillonte tratativat me qeverine Nano per te privatizuar OSSH-ne, por ka rezultuar pa sukses.
 - b.** Ne vitin 2006 me ndryshimin e qeverise, Hamza Merxhani fton Nuel Kalaj nga Prizreni, por me nenshtetesi franceze dhe me banim ne Lion prej 45 vjetesh, per te lobuar me qeverine shqiptare.
 - c.** Ne vjeshten e vitit 2006, sipas vete Nuelit, ai per nje muaj ka kontaktuar mbi 100 here me kryeministrin e asaj kohe Sali Berisha, i cili pasi e degjoi propozimin e tij, ia delegoi kete ceshtje ministrit Ruli.
 - d.** Ne takimin e pare me ministrin Ruli, Nuel Kalaj i ka deklaruar atij se: **"nuk kam ardhur ketu te me shikoni nga kepuçet, por te diskutojme mundesine e privatizimit te OSSH-se nga CEZ-Group sipas rekomandimit te kryeministrit".**
 - e.** Me pas Nuel Kalaj ka kerkuar ballafaqim te tij me ministrin Ruli ne prani te kryeministrit Berisha, kjo pasi ministri Ruli kishte filluar tratativat me kompanine ENEL ENERGJIA.
 - f.** Pas konfirmimit nga ish kryeministri Sali Berisha per privatizimin e OSSH-se nga CEZ-Group, Nuel Kalaj nenshkruan nje kontrate, me CEZ-Group per "Success fee" ne masen 3% te vleres totale te shitjes.

g. Ne vitin 2010 rezultonte nga verifikimet e gjendjes se llogarise personale se Nuel Kalaj ne Raiffeisen Bank se, ai kishte 3.6 milione euro.

h. Keto para u transferuan ne nje destinacion tjetër ne 2011.

i. Dukie patur marredhenie shume te mira me kryeministrin Berisha, Nuel Kalaj krijoi disa firma private sherbimi, ku ofronte sherbime te ndryshme per CEZ-Albania.

j. Nga viti 2006 e deri me tani eshte mik personal i ish kryeministrit Berisha.

k. Me date 31.03.2010, Nuel Kalaj behet aksioner me 49% te shoqerise Antika 04 shpk sot pjese e HAM GROUP me numer nipti K415120191 date 28.02.2012.

m. Me date 08.02.2013, ai eshte larguar si ortak nga kjo shoqeri.

n. Nuel Kalaj njihet si Kalores i Urdherit te Maltes per Kosoven.

o. Aktualisht jeton ne Prizren dhe merret me agrobiznes.

p. Zoteron nje apartament tek Zogu i Zi ne Tirane.

q. Gruaja e tij e dyte eshte me origjine nga Erseka dhe me te ai ka dy femije.

r. Shfaqet qarte ne nje foto me ish ministrin Ruli.

s. Ne nje foto tjetër shqafet me Hamza Merxhanin dhe nje ish deputet dhe drejtues i CEZ-Shperndarje te Rajonit Fier, Albert Faruku.

t. Ne nje foto tjetër shfaqet ai, i vellai i tij Mikeli, Hamza Merxhani dhe nje person i forcave speciale qe e shoqeronte.

Duke vazhduar me tej me investigimin tim, une kam hasur ne te tjera e-maile si me poshte:

34.01 Me daten 11 Maj 2010 ne oren 9: 10, Nuel Kalaj i ka derguar nje e-mail Tomas Pleskash, zv.drejtor i CEZ-Group. Subjekti i e-mailit eshte:"Kosova". Midis te tjerave ne perrnbajtje te ketij e-maili kemi prononcimin e Nuel Kalaj si me poshte: ... **"paraprakisht ju kam informuar se marreveshja me ERE-n do te jete nenshkruar shume shpejt, sidoqofte, ne kete moment Qeveria e Shqiperise po negocion per te marre hua, dhe ..."**. (E- 03)

34.02 Ne daten 15 Maj 2010 ne oren 12:05, Nuel Kalaj i ka derguar nje e-mail Jozef Hejsekut, me subjekt: Report. Ne piken 6, faqe dy te ketij e-maili, Nuel Kalaj shprehet se: **"z.Hejsek nuk e ka kuptuar se une nuk mund te bashkepunoj me njerez te cilet jane teresisht te implikuar ne korrupsion dhe qe japin informacione te rreme ne lidhje me situaten" ... Po keshtu, ai paralajmëron Hejsekun se:" une do ta coj deri ne fund ate cfare kam nisur. Une do te informoj drejtorin e pergjithshem te CEZ-it, z.Martin Roman, kryeministrin e Shqiperise, si dhe palet e interesuara"**. Ai e mbyll kete e-mail te gjate prej rreth 6 faqesh me nje paralajmërim per Jozef

Hejsekun: "Mos u surprizoni z.Hejsek nese nesor ju do te perballeni me gjykatën dhe te shpalleni person non grata ne territorin e Shqiperise. Fillimisht une do t'ia dergoj kete raport z.Merxhani. Pasi z.Merxhani te jete informuar per situaten do te komunikohet me z.Hejsek, Martin Roman dhe institucionet shqiptare. Ne kete raport jane vetem nje pjese e vogel e situates, sepse nese ne do te fillojrne nje investigim, ai do te trondise si termet kompanine". (E- 04)

- 34.03** Ne datën 28 janar 2010, ora 12:40, Jozef Hejsek i dergon nje e-mail Tomas Pleskash ku nder te tjera i thote:..."me Nuelin sapo mbarova negociatat e tjera. I shpjegova ne detaje se cfare ne kerkojme. Takimi me te birin, sipas Nuelit, eshte shtyre per nesor pas ardhjes se PM. (Shenim i perkthimit: PM eshte shkurtim per Kryeministrin.) Mbreme kam shtrenguar duart me Kryeministrin ne takimin me investitoret. Ai tha se eshte i kenaqur qe do te te takoje nesor. Cfare duhet te presim nga Kryeministri. Sipas Nuelit rezultatet ne menyre te sigurt do te jene pozitive dhe 90% konkrete. Ai me siguroi se per Kryeministrin po punon nje komision nderministror, i cili ne menyre te specializuar po trajton problematiken tone. (Mund tju konfirmoj qe kam folur me disa anetare te komisionit qe po merren me kete marreveshje)" (E - 05).
- 34.04** Me datën 17 Nentor 2011, ora 3:37 Jozef Hejsek i ka nisur Nuel Kalajt nje e-mail me subjekt: Banka Boterore- Njoftimi i ngjarjes- Hejsek shkruan: "Kete mbremje kemi qene keshilluar se sot eshte dita e duhur per te dorezuar njoftimin tone per rastin e garancise te pjeshme te riskut, duke reflektuar vendimin e ERE-s lidhur me studimin e borxhit te keq te Deloitte ... ". (E- 06)
- 34.05** Ne e-mailin e dates 15 maj 2010 une rikonfirmova se, informacioni i dhene nga Beg Rizaj, ishte i sakte, persa i perket personit Hamza Merxhani, i cili permendet tashme ne kete e-mail, si nje person te perfshire ne biznesin e CEZ-it.
- 34.06** Theksoj se, te gjitha keto e-maile, jane fakte dhe prova te reja, lidhur me kete ceshtje, dhe cdo arsyetim se, kjo ceshtje eshte gjykuar me pare, bie poshte pikerisht edhe per kete arsye.
- 34.07** Duke pasur tashme kete informacion, une mblodha dokumente dhe investigova me hollesi proceduren e privatizimit te OSSH-se, duke konstatuar disa problematikat shqetesuese si me siper.
- 35. Mosnjoftim i vazhduar nga prokuroria dhe gjykata si dhe disa mangesi pergjate procesit te hetimit.**
- 35.01** Per here te pare, Prokuroria e Tiranes, tentoi ta pushoje kete ceshtje, sapo ajo e mori ne dorezim kete dosje disa mijera faqe, pothuaj vetem pas tete ditesh, ne shtator 2017.
- 35.02** Une si kallezuesi i pare lidhur me kete ceshtje, nuk jam njoftuar dhe kam marre dijeni vetem nga media pas rreth dy muajsh.

- 35.03** E kam rivendosur te drejten time te ankimimit ne afat, dhe me pas me ane te vendimit 240 date 15.12.2017 Gjykata Penale e shkalles se Pare Tirane, vendosi te pranoje kerkesen time dhe te Kuvendit te Shqiperise per kthimin e dosjes per plotesim hetimi nga ana e prokurorise.
- 35.04** Per me teper se dy vjet, as nga ana e prokurorise dhe as nga ana e gjykates, une nuk jam njoftuar asnjehere, lidhur me seancat te zhvilluara per kete ceshtje.
- 35.05** Po keshtu edhe me kerkesen e radhes se prokurorise per pushimin e ceshtjes, une jam njoftuar vetem nga media.
- 35.06** Duke u konsultuar me dosjen e plote, si dhe fashikujt shtese te prokurorise, une konstatoj se, prokuroria ka deshtuar qe t'a trajtoje kete ceshtje sipas tere rubrikave te saj, si dhe ka anashkaluar pa dhene asnje justifikim fakte shume te rendesishme, qe kane te bejne me kete ceshtje si me poshte:
- 35.07** Mostrajtimi si prova shume te rendesishme te e-maileve te ofruara per here te pare nga une si evidence te reja ne kete process.
- 35.08** Interesant eshte fakti se pas verifikimeve qe ka bere komisioni hetimor parlamentar, u verifikua si e vertete se, Nuel Kalaj kishte pasur te depozituara disa milione euro ne Raiffeisen Bank te ardhura nga CEZ-Group. Shuma qe iu verifikua nga ky komision ishte pothuaj dyfish me e larte se sa ishte ofruar nga ky informacion.
- 35.09** Ajo qe prokuroria nuk ka bere dhe nuk ka vleresuar eshte pikerisht fakti kokeforte se, Nuel Kalaj ka marre nje shume jashtezakonisht te madhe parash, ne harkun kohor janar 2008-qershor 2009.
- 35.10** Kjo kohe korrespondon pikerisht me fazen zyrtare te zhvillimit te procesit te privatizimit te OSSH-se, nga njoftimi per fillimin e procesit deri tek miratimi ii kontrates ne parlament.
- 35.11** Edhe pse ne komisionin hetimor parlamentar te ngritur per kete qellim, u pranua nga nje prej deshmitareve se, Nuel Kalaj i ka terhequr keto para ne kundershtim me ligjin, perseri prokuroria e anashkaloi kete fakt.
- 35.12** Po keshtu, ne intervistat publike, qe vete Nule Kalaj ka dhene ne fillim vitin 2017, ai ka pranuar se i ka nxjerre ato para ne menyre te jashteligjshme nga vendi, duke e inkriminuar veten e tij. Perseri prokuroria nuk e ka marre parasysh kete fakt.
- 35.13** Nuel Kalaj kurre nuk ka punuar ne ndonje sektor energjetik perpara se te perfshihej ne kete afere dhe theksoj se, edhe pas vitit 2013, vit ne te cilin PD-ja u largua nga pushteti, ai perseri kurre nuk ka punuar ne kete sektor.
- 35.14** Prokuroria do te duhej qe, kete fakt te pamohueshem, qe Nuel Kalaj eshte shperblyer me nje shume te cmendur success fee, e cila e tejkalon edhe ate te kompanise konsulente IFC, te mos e linte qellimisht jashte vemendjes se saj, duke e trajtuar ceshtjen jo ne rrugen e zbardhjes se plote te saj por ne ate te mbylljes se saj.
- 35.15** I gjithe institucioni i prokurorise, filluar nga ai i prokurorise se pergjithshme dhe vazhduar me ate te Tiranës, kane patur si qellim jo zbatimin e ligjit dhe zbardhjen e kesaj ceshtjeje, por mbylljen e saj dhe venien nen sherbim te ish pushtetareve, qe jane perfshire ne kete afere.

- 35.15** Llogjika e ngjarjes nuk mund t'a pranoje se, nje njeri nga hici, pa asnje njohje dhe arsim specifik lidhur me sektorin energjetik si Nuel Kalaj, te shperblehet me nje shume te tille prej 6.8 milione eurosh. Me siguri keto para qe nuk kane qene vetem per Nuel Kalajn por edhe per personat e tjere per te cilet ai ndermjetesonte.
- 35.16** Prokuroria do te duhet qe, te merrte ne ndjekje penale personat qe ne kundershtim me ligjin e lejuan Nuel Kalajn, qe t'i terhiqte ato para nga banka ne menyre te jashteligjshme. Sipas transaksioneve te verifikuara tashme, ai ka bere terheqje edhe ne shumen 1 milion euro brenda dites, gje qe nuk mund te behet pa miratimin e strukturave shteterore, qe merren me pastrimin e parave, si dhe pas paraqitjes se nje sere dokumentash justifikuese, te cilat ai nuk i ka paraqitur.
- 35.17** Pra, ka pasur nje strukture te plote shteterore dhe bankare, qe ia ka mundesur ketij personi dhe te tjereve mbas tij, qe te realizohen keto trasferta. Ne kete rast lista e personave te kallezuar dhe hetimi do te duhej qe te zgjeroheshin dhe faktet te rriteshin ne favor te akuzes.
- 35.18** Pyetja ime eshte: perse prokuroria nuk ka verifikuar tabulatet e bisedimeve telefonike te ish kryeministrit Berisha, per te verifikuar si te vertete kete pretendim te ofruar nga ky informacion dhe a jane takuar realisht Berisha-Ruli-Kalaj ne nje ballafaqim ndermjet tyre ne vitin 2006?
- 35.19** Perse prokuroria nuk perdori forma te tjera operative te hetimit?
 Cili ishte aktiviteti i Nuel Kalajt perpara ketij procesi privatizimi?
 Cili ishte aktiviteti i tij pas ketij procesi?
 Per cfare arsye ai paguhet me miliona euro si success fee biles fillimisht ne te njejten shifer 3% te vleres se privatizimit aq sa i eshte ofruar edhe kompanise konsulente IFC?
 A jane te verteta takimet e Nuel Kalajt me ish ministrin Ruli?
 Per cfare arsye dhe cili person i ka siguruar mbrojtje te vecante te mbuluar nga forcat speciale Nule Kalajt?
 Perse Nuel Kalaj u be aksioner tek Antika 04 ne vitin 2010 dhe u largua ne 2013?
 A ka lidhje kjo periudhe me kohën e aktivitetit te CEZ-it ketu si dhe me qenien ne pushtet te Sali Berishes?
 Keto jane pyetjet qe kane kane marre pergjigje nga prokuroria.
 A jane keto e-maile reale dhe te pamanipuluara?
 Si shpjegohet qe, per privatizimin e OSSH-se nga CEZ-i, paskan punuar se bashku paraprakisht, qe prej vitit 2005, Nuel Kalaj dhe ceku Petran, i cili ka qene me pas perfaqesues i CEZ-it ne procesin e negocimit OSSH-CEZ?
 A eshte parapergatitur kjo procedure nga nje bashkepunim shqiptaro-cek qe prej vitit 2005?
 Kush e mandatoi Nuel Kalajn per te bere kete pune kater vjecare per futjen e CEZ-it ne Shqiperi?
 Nese Nuel Kalaj dhe ceku Petran, realisht kane punuar per kete qellim, a flet ky fakt per nje kompromentim te te gjithë procesit te privatizimit te OSSH-se, qe pretendohet se eshte bere me nje tender te hapur nderkombetar ne vitin 2008?
 Cfare hetimi eshte bere lidhur persa me siper?
 Si eshte siguruar prokuroria e Tiranes se ky e-mail nuk shpreh realitetin dhe se kjo procedure prokurimi ka qene e rregullt?
 A u pyet Nuel Kalaj? Pergjigja eshte jo.
 A duhet te mjaftohemi ne me mosarritjen e pyetjes se tij, nderkohe qe e gjithë ceshtja eshte

pothuaj e zbardhur ne te gjitha aspektet?

A u pyeten ish-drejtuesit e CEZ-it te cileve ju eshte derguar ky e-mail? Perseri jo, por kjo nuk do te thote se mospyetja e krimineleve dhe abuzuesve do te mbaje peng kete ceshtje penale. Perse qenka kaq e veshtire per t'u gjendur Nuel Kalaj, te cilin une personalisht e kam denoncuar neper rrjetet sociale, per veprimtarine e tij te hapur publike, ne favor te nje partie politike ne Kosove?

A jane marre parasysh deklaratat publike te Nuel Kalajt ne fillim te vitit 2017, ku ai deri diku ka pranuar konsumimin e vepres penale te pastrimit te parave dhe mosdeklarimit te tyre ne kufi? A jane bere investigime te plota lidhur me 6,8 milione euro qe kane hyre dhe kane dale nga llogaria e Nule Kalajt nga janari i vitit 2008 deri ne qershor te vitit 2009?

Cfare mendon prokuroria rreth ketyre transakcioneve te pazakonta bankare?

Perpara komisionit hetimor parlamentar, nje nga nenpunesit e pastrimit te parave qe ka qene ne detyre ne ate kohe, e pranoi publikisht se terheqja e ketyre parave ishte e paregullt.

Si mendon prokuroria se kjo gje mund te kaloje ne heshtje?

A ka bere prokuroria nje harte te mundshme te qarkullimit te parave te perfolura lidhur me kete ceshtje?

Ku i ka cuar parate Nuel Kalaj?

Kush fshihet pas tij?

Perse nuk u ndoq deri ne fund nepermjet hetimeve te hollesishme duke perfshire banken dhe drejtorine e pastrimit te parave lidhur persa me siper?

Cfare profili ka krijuar prokuroria lidhur me personin e Nuel Kalajt?

Cili eshte arsimimi i tij?

Cila eshte veprimtaria e tij perpara privatizimit te OSSH-se?

Perse u perzgjodh ky person per t'i ofruar keto sherbime CEZ-it?

Ky person pretendohet se eshte zgjedhur nga CEZ-i. Perse ky person vepron dhe prononcohet si nje garant dhe ndermjetes midis CEZ-it dhe autoriteteve shqiptare?

Cilat kane qene lidhjet e tij me ERE-n?

Kane qene lidhje direkte, apo indirekte, nepermjet ministrit te linjes apo kreut te qeverise?

Cilet jane njerezit teresisht te korruptuar te cilet permend Nuel Kalaj ne evidencen 04?

A eshte pyetur ish kryeministri i Shqiperise, lidhur me ate qe deklaroi Nule Kalaj ne kete e-mail, se ai do te informoje kryeministrin e Shqiperise?

Cilat jane lidhjet e ketij personi me ish kryeministrin e Shqiperise?

Perse ky person shprehet kaq konfident lidhur me ish kryeministrin e Shqiperise, aq sa ai e di se, per ish kryeministrin po punonte nje komision nderministror?

Perse pala ceke nuk e ve asnjehere ne diskutimbueshmerine e ketij personi kur ai shprehet per kryeministrin e Shqiperise, por perkundrazi i transmetojne theniet e tij me shume seriozitet dhe si te besueshme? Cfare dinte Nuel Kalaj per veprimtarine e Jozef Hejsekut, qe e justifikonte ate per te thene: se ju do te perballeni me gjykatën dhe do te shpallen person non-grata ne territorin e Shqiperise?

Cili ishte termeti qe do te trondiste kompanine, sipas Nuel Kalajt?

Cfare negociatash ka bere Jozef Hejsek me Nuel Kalajn ne janar 2010 sipas evidences 05?

Ke perfaqesonte Nuel Kalaj ne keto negociata?

A ka bere verifikime prokuroria nese aktiviteti i kryeministrit te Shqiperise eshte ai qe pershkruhet ne evidencen 05?

Sipas asaj qe une kam mesuar nepermjet shtypit dhe pikerisht gazetes Tema, e cila ka bere nje perskrim te sakte te aktivitetit te kryeministrit shqiptar ne ate periudhe, duke rikonfirmuar vertetesine e asaj cfare thuhet ne kete prove, eshte e pamundur per te mos e konsideruar te vertete edhe kete pjese te rolit te Nuel Kalajt si negociator ne emer te nje apo dy paleve, apo ndermjetes midis tyre, a perben shkelje penale qe interesat e shtetit shqiptar dhe vullneti i tij te kanalizohet kaq hapur nepermjet nje personi qe nuk eshte as i zgjedhur dhe as i emeruar zyrtarisht?

A nuk eshte veprimtaria e tij, nje shkelje e hapur e ligjeve ne kete rast dhe pikerisht e ushtrimit te ndikimit te paligjshem?

Pse nuk u mor ne pyetje gazetarin e gazetes Tema qe e ka cekur hollesishem kete rast ne fillimvitin 2017, duke treguar se sa sakte perputheshin theniet e Jozef Hejsekut me realitetin dhe axhenden e ish kryeministrit Berisha?

Ne kete e-mail jane perfshire direkt dhe indirekt te pakten pese persona: Jozef Hejsek, Tomas Pleskash, Nuel Kalaj, Sali Berisha dhe Shkelzen Berisha. Kam mesuar se prej tyre eshte pyetur vetem njeri prej tyre: Shkelzen Berisha. Pyetja eshte: perse nuk jane pyetur te tjeret?

Nese pergjigja eshte se ata ndodhen ne Ceki, po Sali Berisha, ku ndodhet qe nuk eshte marre ne pyetje?

Duke lexuar evidencen 06 ku Jozef Hejsek, i thote Nuel Kalajt: Kete mbremje kemi qene keshilluar se sot eshte dita e duhur per te dorezuar njoftimin tone per rastin e garancise te pjesshme te riskut, duke reflektuar vendimin e ERE-s lidhur me studimin e borxhit te keq te Deloitte, cfare perfundimi nxjerr prokuroria dhe gjykata?

Cili eshte roli i Nuel Kalajt dhe kush ja ka ngarkuar ate?

A eshte i ligjshem ky rol i tij?

Perse fshihet Nuel Kalaj?

Ai eshte nje qytetar i Republikes se Shqiperise dhe duhet t'i bindet thirrjes se Kuvendit te Shqiperise dhe prokurorise per te deshmuar. Mjafton kjo mosbindje qe ai te inkriminohet dhe te merret forcerisht per t'u pyetur.

Ne fillim te vitit 2017, Nuel Kalaj eshte shprehur publikisht se ai brenda nje jave do te vinte te deshmonte perpara komisionit hetimor parlamentar.

Cfare ndodhi qe ai jo vetem nuk erdhi, por edhe nuk u prononcua me ne media?

A nuk eshte kjo nje shenje e qarte se ai dhe te tjere mbas tij jane te inkriminuar, nuk duan zbardhjen e kesaj ceshtjeje dhe se vete Nueli eshte nen presion?

36. Prokuroria dhe gjykata nuk kane dashur qellimisht, qe te gjejne te tjera prova ne mbeshtetje te fakteve te ofruara nga une.

36.01 Prokuroria e Tiranes, edhe pse i ka te gjitha faktet e parashtruara nga une dhe Kuvendi i Shqiperise, ajo nuk do kurrese te gjeje provat ne mbeshtetje te ketyre fakteve.

36.02 Lidhja shkak-pasoje e ngjarjeve eshte teper e qarte dhe nuk le vend per medyshje dhe demi ekonomik eshte tashme i konstatuar ne menyre te pakundershtueshme.

36.03 Mosarrestimi i te kallezuarve, mossekuestrimit i pasurise se tyre, pushteti absolut politik dhe ekonomik qe ata kane, ka sjelle si pasoje stepjen e prokurorise dhe paralizimin e punes se saj.

- 36.04** Une konstatoj s,e investigimi i kesaj ceshtjeje vetem me nje prokuror, eshte pothuaj i pamundur. Kjo ceshtje pervec volumit te jashtezakonshem, pasi jane nje sere veprash penale te pacituara nga ana ime dhe e Kuvendit, ka dhe nje impakt te jashtezakonshem politik, prandaj prokuroria ka zgjedhur qe ne heshtje te mos e ngacmoje kete ceshtje dhe personat e perfshire ne te. Kete ceshtje do te mund t'a hetojne vetem nje grup prokuroresh me status dhe trajtim te vecante.
- 36.05** Kjo ceshtje, tashme e mediatizuar dhe pertej interesit te ngushte, do te duhej te hetohej qe ne krye te heres duke zbardhur arsyen se, "perse ish kryeministri Nano nuk ka pranuar te bashkepunojte me CEZ-in lidhur me privatizimin e OSSH-se kur keta iu ofruan perpara se Berisha te vinte ne pushtet".
- 36.06** Hetimi do te duhej te ishte zgjerues dhe jo ngushtues, me nje tendence te paster vetem per t'a mbyllur kete ceshtje me cdo mjet.
- 36.07** Referimi qe i behet ne kete ceshtje vendimit te prokurorise se pergjithshme, per t'a mbyllur kete hetim, eshte perseri i papranueshem, pasi ne kemi tashme edhe nje hetim parlamentar pervec investigimit tim, me nje tjetere qasje, me prova dhe fakte te reja, te cilat mbi te gjitha provojne se, procesi real per privatizimin e OSSH-se ka filluar perpara vitit 2008, ne bashkepunim te paligjshem me CEZ-in dhe ne kundërshtim me interesat e Shtetit Shqiptar, duke sjelle si pasoje deme fatale per buxhetin e shtetit. Askund te vendimi e prokurorise se pergjithshme nuk permendet fare Nuel Kalaj, transfertat e tij bankare ne shume e 6.8 milione eurove, ndikimi i tij perpara vitit 2008 ne bashkepunim me stafin cek per te beret e mundur privatizimin e OSSH-se nga CEZ-i.
- 36.08** **Nese personat e quajtur kyc ne kete ceshtje si Nuel Kalaj, nuk do te paraqiten dhe do te mbahen jashte ketij hetimi me apo pa dhune, prokuroria dhe gjykata mund te shkojne drejt nje gjykimi ne mungese te tyre.**
- 36.09** Ajo qe une kam thene prej kohesh se, mosarrestimi i Sali Berishes dhe bashkepunetoreve te tij ne kete proces, do te sillte cenimin e integritetit te ketij procesi, ndodhi. Duke qene i lire, i paprekur ne te gjitha kuptimet, ai me siguri ka mundur qe te ndikoje ne qendrimin e ish stafit drejtues cek te CEZ-it si dhe te sekserit te tij Nuel Kalaj. Nuel Kalaj jo rastesisht ka qendruar jashte vendit apo mund te kete udhetuar me identitet te rreme, dhe jo rastesisht ka bere edhe karshillik duke u bere publik edhe me disa statuse politike ne Kosove. Besoj se ai ka marre tashme garancine absolute se, per momentin askush nuk do t'a preke ate. Per kete person do te duhet nje hetim me shume se i plote, pasi perflitet se ka qene i inkriminuar qe ne krye te heres prej fillimit te viteve 90.
- 36.10** Edhe nese supozojme se, prokuroria nuk mund te avancoje me tej me kete hetim, perseri kjo ceshtje nuk mund te mbyllet, pasi faktet jane aty, provat gjithashtu dhe pasojat e renda te vepres penale. Kemi nje numer jashtezakonisht te madh te veprave penale, te cilat edhe nje i verber i konstaton qartesisht ato. Ky privatizim jo vetem qe ishte i nxituar, por ishte edhe i paravendosur duke shkelur barazine ne tendera. Kontrata nuk eshte lidhur sipas parashikimeve ligjore Brenda 30 diteve nga shpallja e fituesit,

por është lidhur pas disa muajve.

Moslidhja e kontratës Brenda 30 diteve e detyronte ligjerisht Shtetin shqiptar që të konfiskonte sigurimin e ofertes, e cila në mënyrë antiligjore ishte në një vlerë shumë më të ulët se sa ishte parashikuar.

Jane ndryshuar specifikimet teknike të parashikuara nga qeveria me anë të dy VKM-ve. Jane kaluar padrejtesisht detyrimet e OSSH tek KESH-i.

Komisionet janë ngritur në kundërshtim me ligjin.

VKM-ja që parashikon që tarifën e suksesit duhet të paguaje fituesi është ngritur në kundërshtim me ligjin, pasi ligji parashikon që këto tarife duhet t'ia paguaje shteti shqiptar.

Pagesa e kësaj tarife minimumin përben një dem ekonomik, për të mos thënë një abuzim të justifikuar mbas një akti nenligjor.

- 36.11** Duke e cuar këtë çështje për gjykim, unë jam i sigurtë se, në do të hasim edhe në vepra të tjera penale të papermendura nga unë dhe Kuvendi.
- 36.12** Pergjate gjykimit, akuza mund të ndryshohet, vepra të tjera penale të konstatohen, pra akuza të shtohet, të dalin fakte të reja si dhe mund të bëhet ndryshimi i cilesimit juridik të veprës penale. Prokuroria është mjaftuar vetëm me dy cilesime të akuzës si "ushtrimi i paligjshëm" dhe "pastrimi i produkteve të veprës penale", nderkohe që qartësisht kemi konkurimin e disa veprave penale si shpërdorimi i detyrës, korrupsioni, shkelje të barazisë nëpër tendera publike, mashtrimi etj.

37. Pyetjet që nuk iu bënë ish ministrit Ruli.

- 37.01** Në kreun 7 pika 1 të VKM nr 829, dt 12.07.1999 "Për procedurat e Tenderit për zgjedhjen e Investitorëve Strategjikë dhe për transferimin e aksioneve të zotëruara nga Shteti në Shoqëritë Tregtare të Sektorëve me Rëndësi të Veçantë" përcaktohet se:

-Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të jetë Komiteti i Konsulencës dhe i Transparencës në përputhje me VKM nr 621, dt 25.09.1998 si edhe një përfaqësues i Agjencisë Kombëtare të Privatizimit.

Në pikën tre të VKM nr 621, dt 25.09.1998 "Për krijimin e Komitetit të Konsulencës dhe Transparencës për privatizimin e sektorëve me rëndësi të veçantë të Ekonomisë" përcaktohet se:

Komiteti përbëhet nga 13 anëtarë, dy përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë (publike dhe të privatizimit), një përfaqësues nga Ministria e Financave, një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, dy përfaqësues nga organet përkatëse që përgjigjen për Administrimin e Pronës Shtetërore të cilën e kanë në vartësi edhe 6 anëtarë të tjerë që do të caktohen ndërmjet konsulentëve financiarë, ligjorë dhe të marketingut, të seleksionuar në nivel ndërkombëtar nëpërmjet procedurave konkurruese të njohura nga Banka Botërore.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për privatizimin e OSSH-së është ngritur me urdhrin nr 329 dt 13.05.2008 dhe ka patur në përbërjen e tij 5 përfaqësues të METE-s dhe 4 përfaqësues të IFC-së.

Pra, ky komision ka qene në kundërshtim të hapur me 2 VKM-të e lartpërmëndura. Bazuar në këto VKM, vetë ishministri Ruli duhej te ishte kryetar i këtij komisioni, pasi ka qenë njëkohësisht Ministër dhe Kryetar i Komisionit të Konsulencës dhe Transparencës. Në realitet ai nuk figuron as anëtar dhe as kryetar i këtij komisioni.

A duhej t'i delegonte ishministri Ruli kompetencat e tij, si kryetar i Komisionit të Konsulencës dhe Transparencës, paraprakisht tek kryetari i ardhshëm i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave?

Përse ai nuk e beri këtë veprim?

- 37.02** Përveç dy VKM –ve të mësipërme, Këshilli i Ministrave me dt 16.04.2008 ka nxjerrë VKM me nr 487 “Për kriteret e përzgjedhjes së investitorëve strategjikë të interesuar për blerjen e aksioneve të shoqërisë OSSH”

Kjo VKM në pikën 4 të saj parashikon se, dokumentacioni i tenderit për parakualifikimin dhe vlerësimin e ofertave paraprake bëhet nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i cili krijohet me urdhër të Ministrit të Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës.

Mënyra se si është hartuar kjo VKM duke i dhënë të drejtën ish ministrit Ruli, të ngrinte me urdhrin tuaj Komisionin e Vlerësimit të Ofertave automatikisht e ka vënë ate në pozitën e konfliktit të interes, për të mbajtur njëkohësisht, postin e ministrit dhe atë të kryetarit të Komisionit të Konsulencës dhe Transparencës, pasi në këtë rast ai nuk mund të nxirrte një urdhër për veten e tij.

Përse ai nuk ndërmorri veprimet e duhura për të dalë nga ky konflikt ligjor, por krijoi një Komision Vlerësimi Ofertash totalisht në kundërshtim me parashikimet ligjore?

- 37.03** Pika 4 e VKM 487, dt 16.04.2008 bashkon kompetencat e personave që hartojnë dokumentat si dhe të atyre që i vlerësojnë ato.

Kjo gjë bie në kundërshtim me parimet e tenderit si edhe me VKM nr 1 ,dt 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” në piken 1 a) dhe 2 ç) të saj, ku parashikohet se, duhet të sigurohet një ndarje e qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve të përfshirë në hartimin e dokumentave të tenderit dhe atyre të përfshirë në përzgjedhjen e fituesve.

Pra Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet te ishte përgjegjës vetëm për shqyrtimin e ofertave.

Cili ka qenë qëndrimi i ish ministrit Ruli përgjate kohës kur është miratuar VKM me nr . 487 dt 16.04.2008 në lidhje me pikën 4?

- 37.04** Neni 11 i Ligjit 8306 të vitit 14.03.1988 “Për privatizimin e Sektorëve me Rëndësi te Veçantë”:

-Per përcaktimin e procedurave të privatizimit që nga momenti i publikimit duhet të respektohej një afat minimal tre mujor me qëllim sigurimin e transparencës. Vendimi i Komitetit të Konsulencës dhe Transparencës nr 3 dt 09.05.2008 i firmosur nga ish ministri Ruli si kryetar i këtij Komiteti parashikonte publikimin e shprehjes së interesit vetëm 25 ditë përpara datës së dorëzimit të ofertave parakualifikuese.

Përse nuk u respektua afati ligjor prej tre muajsh i cili do të bënte të mundur sigurimin e transparencës?

Perse dhe si ish ministri Ruli ka nxjerre nje urdher te tille?

37.05 Komisioni i Vleresimit te Ofertave per Privatizimin e OSSH-së është ngritur me urdhrin e ish ministrit Ruli nr 339 dt 13.05.2008.

Si shpjegohet që ky komision po në dt 13.05.2008 me anë të Vendimit nr 1 të tij miraton dokumentat e tenderit për fazën e parakualifikimit (të përgatitur nga konsulentët e IFC-së) dhe delegon kompetencat e tij tek Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Tregtare pranë METE-s si edhe tek konsulentët e IFC-së?

Si e shpjegoni ai këtë veprim të këtij Komisioni, i cili miraton dokumentat e tenderit të privatizimit më të rëndësishëm në Shqipëri pikërisht brenda ditës në të cilën krijohet?

Si e shpjegoni ai delegimin e kompetencave që ky komision ka me VKM në drejtim të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Tregtare dhe konsulentëve të IFC-së?

Ky Komision është ngritur me anë të VKM nr.487, dt 16.04.2008 dhe atje nuk parashikohet asnjë kompetencë e tillë ku ky komision mund ti delegojë detyrat e tij apo të ketë tagër urdhërues karshi subjekteve të tjera jashtë përbërjes së tij .

37.06 Përse nuk gjëndet pranë protokollit të Ministrisë së Energjitikës si edhe pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Tregtare një protokoll i plotë dhe i saktë për këtë procedurë privatizimi duke qënë se kjo është një kërkesë ligjore nga pika tre e nenit 42 të Ligjit të Prokurimit Publik?

37.07 Përse ish ministri Ruli pranoi që, te hynte në një procedurë të tillë privatizimi, pa zgjidhur transferimin e titujve të pronësisë së Aksioneve të Shoqërisë OSSH nga KESH-i tek METE?

Egzistojnë një sërë shkresash të cilat provojnë se përgjatë gjithë kësaj procedure privatizimi ai paralelisht ka ndërmarrë veprime, që kanë të bëjnë me regjistrimin e aseteve të OSSH dhe transferimin e titujve të pronësisë. Pra, ai ka hyrë ne procedurën e privatizimit, pa zgjidhur më parë këtë problem.

Cili ka qënë shkaku që e ka detyruar ate që të vepronte në këtë mënyrë?

(Vendim nr 4 dt 09.05.2008 i Komitetit të Konsulencës dhe Transparencës :

Pika tre. Të fillohet procedura për transferimin e titujve të pronësisë së shoqërisë OSSH nga KESH tek Mete.

Pka 4. Heqje nga inventari i disa aseteve të OSSH sipas raportit të grupit te punës të ngritur për këtë qëllim.

Urdhër 329 dt. 09.05.2008

Pika 1: Fillim i i procedurave juridike për transferimin e titujve të pronësisë së aksioneve të shoqërisë OSSH nga KESH tek Mete .

Pika tre. Drejtorja e shoqërisë KESH të marrë masa për kryerjen e procedurave të depozitimit dhe regjistrimit të ndryshimeve në QKR.

-Shkresa 12.05.2008 nr 329

-Shkresa 12.05.2008 nr 329/1

-Shkresa 08.07.2008 nr 6466 ku i kërkohet Zyrës Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, regjistrimi i pasurive të paluajtshme të shoqërisë OSSH (pra megjithëse dokumentat parakualifikuese janë dorëzuar në dt. 02.06.2008, edhe disa javë më pas asetet e OSSH kanë qënë të paregjistruara pranë ZQRPP).

37.08 A ka qënë i bindur ishministri Ruli se, ishin pjekur kushtet për privatizimin e OSSH-së në vitin 2008?

(Banka Botërore dhe Komisioni Europian kanë konstatuar se ky proces ka qënë i nxituar.)

Ksenyia Volvsky drejtore e Bankës Botërore Tiranë, ka deklaruar në Dhjetor të vitit 2012 se ky proces ka qënë i nxituar pavarësisht se në e kemi mbështetur një hap të tillë. Në mbledhjen e qeverisë të datës 17.09.2008, zëvendësministri i Integritetit të asaj kohe Albert Gajo ka thënë se, shqetësimi i specialistëve të Komisionit Europian është se, një ndërmarrje me bilanc negativ nuk mund të privatizohet.

37.09 A ishte i bindur ai se legjislacioni i kohës, në të cilën u krye privatizimi i OSSH, ishte i mjaftueshëm për këtë qëllim?

Nese jo, përse nuk ndërmorri më parë plotësimin e kuadrit ligjor për këtë lloj privatizimi?

37.10 A duhej përdorur ndonjë procedurë tjetër për privatizimin e OSSH, psh ankandi?

37.11 Përse ai ndërmorri një proces të tillë privatizimi pa u testuar më parë “Modeli i Ri i Tregut të Energjisë”?

A nuk do të ishte mëse e llogjikshme që OSSH-ja e sapoformuar, dhe e ndarë më vete nga KESH, të testohet në këtë treg të ri paraprakisht, duke ofruar edhe një ide më të saktë në lidhje me vlerën reale të asetëve të saj?

37.12 Përse nuk është respektuar afati ligjor lidhur me dorëzimin e ofertave?

(Sipas ligjit të prokurimit ky afat ligjor duhej të ishte jo më pak se 52 ditë nga data në të cilën është bërë njoftimi i prokurimit. Njoftimi i prokurimit është bërë me dt 09.05.2008 me anë të vendimit nr 3 dt 09.05.2008 të Komitetit të Konsulencës dhe Transparencës, ndërsa procedura për parakualifikim ka filluar me 2 Qershor 2008, pra, vetëm pas 23 ditësh).

37.13 Përse u negociuan kushtet e Tenderit të miratuar me VKM pasi CEZ-i u shpall fitues, bazuar në këto kushte?

Behet fjalë për procesin e negociimit, të zhvilluar pas datës 29.09.2008 datë në të cilën u bë dorëzimi i ofertave.

37.14 Përse u lejua të ndryshohej niveli i borxhit të keq nga 4% në 14% si edhe niveli i fitimit nga 1% në 2% po kështu edhe kushte të tjera të parashikuara me VKM nr. 835 dt 11.06.2008?

Palët kanë pasur të drejtë vetëm të trajtojnë diskutimin e borxhit të keq, kush do të quhej borxhi i keq dhe jo nivelin e tij i cili ishte përcaktuar paraprakisht në Deklaratat Rregullatore të ERE-s në masën 4%.

37.15 Perse lejoi qe pas dorezimit te ofertave ne daten 29 shtator 2008, te zhvleresohej cdo parameter i tenderit te hapur nderkombetar, duke kaluar ne nje procedure negociimi e cila realisht e ktheu procesin ne nje tender te drejtperdrejte?

37.16 Në asnjë nga proçes-verbalet e negociimit me palën ceke nuk është përmendur zhvleresimi i aseteve te OSSH-së. Për herë të parë ishte pikerisht ai qe e ngriti një problem të tillë në mbledhjen e përbashkët të Komitetit të Konsulencës dhe Transparencës dhe Komisionit të Negocimit me dt 26.02.2009, ku ka marrë pjesë edhe këshilltarja e kryeministrit, Suzana Guxholli.

Në arsyetimet e ti jai ka thene se, çmimi i blerjes nga Cez-i është përlogaritur duke u bazuar në bilancin e 2007, i cili sipas tij rezultonte me pozitiv se ai i vitit 2008. Ndërkohe zyrtarisht Bilanci i 2008 është miratuar nga Asambleja e Aksionerëve më 18.06.2010.

Si mundet ai ti referohej një bilanci të paçertifikuar dhe të kërkonte një rivleresim të aseteve duke u bazuar vetëm në një argumentim të tillë?

Duke iu referuar të dhënave të mëposhtme mund të pohojmë se viti 2008 krahasuar me vitin 2007 në secilin prej pasqyrave financiare rezulton të jetë dukshëm më pozitiv se ai i 2007, përfshirë këtu edhe bilancin kontabël.

	Viti 2008	Viti 2007
Për Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve :	(9.133.938.000 Lekë)	(11.023.662.000)
Bilanci Kontabël :	34.716.915.000	25.989.261.000
Pasqyra e ndryshimeve të flukseve të mjeteve monetare :	844.095.000	238.754.000
Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit aksionar :	13.194.188.000	8.055.889.000

37.17 Përse u desh pjesemarrja e Z.Guxholli në mbledhjen e përbashkët të Komitetit të Konsulencës dhe Transparencës dhe Komisionit të Negocimit?

37.18 Me anë te shkresës nr. 180 dt 09.01.2008 ai i eshte shprehur perfaqësuesit të IFC Angelo Dell' Atti se: detyrimet që lidhen me kreditë dhe huatë e marra nga CEZ për investimet në asetet e OSSH nuk janë detyrimet të Kesh-it. Përse atëherë lejuat që me anë te VKM 218 dt 06.08.2009 ti kalonit detyrimet e OSSH tek KESH-i dhe te favorizoni OSSH-ne ne prag te shitjes se saj me 7.61 mld leke. Konkretisht me ane te kesaj VKM-je jane bere veprimet si me poshte:

a) kane kaluar në favor te OSSH-së asetet e financuara nga KESH-i apo kredi afatgjata të marra nga këto kompani në vlerën prej 1.1 mld lekë.

b) kane kaluar detyrimet e OSSH-së tek Kesh në vlerën 2.68 mld lekë dhe 2.3 mld lekë, investime te Bankës Botërore dhe Bankës Europiane të Investimeve.

c) Detyrimet afatshkurtra për blerjen dhe transmetimin e Energjisë që OSSH i kishte Kesh-it në vlerën 1 mld lekë u shuan.

d) Shuma prej 0,53 mld lekë që i korespondon pagimit të huave afatgjata në vitin 2008 nga KESH vendos të pasqyrohej si rritje kapitali për OSSH-në.

Pra, vetëm me anë të një VKM të nxjerrë me 6 mars të vitit 2009 ju favorizuat CEZ-in me 7.61 mld lekë apo me kursin e atëhershëm 76 mln dollarë.

Cfarë ka ai për të thënë për këtë vendim te marre nga ai dhe qeveria?

Keshtu mendonte ai se duhej të trajtohej klauzola Purchase Price Adjustment?

37.19 **Përse ai nuk konfiskoi garancinë e ofertës pasi kaloi afati 30 ditor pas njoftimit të fituesit dhe marrëveshja nuk ishte nënshkruar nga CEZ?**

37.20 Neni 3 i ligjit nr 9889 dt 20.03.2008 "Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit te shoqërisë OSSH"parashikohet se :

-Pjesa e mbetur e aksioneve të OSSH 24% duhejt të ofrohej :

a) ish subjekteve të shpronësuar të truallit dhe të ndërtesave .

b) punonjësve të OSSH-së në shkëmbim të aksioneve me bonot e privatizimit apo letrave me vlerë.

c) të persekutuarve .

Deri më sot nuk kemi gjetur asnjë lloj akti ligjor apo nënligjor i cili mund të faktojë zbatimin e këtij detyrimi ligjor.

Përse ka ndodhur kjo?

37.21 Neni 3 i ligjit nr 9889 dt 20.03.2008 "Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës se privatizimit të shoqërisë OSSH"parashikon se :

-Të ardhurat nga privatizimi (Shuma prej 102 mln Euro) do të përdoreshin për:

a) Mbulimin e shpenzimeve për organizimin e procedurave të tenderit dhe për veprimtari të tjera që i nevojiteshin procesit të privatizimit.

b) Pagesën e tarifës së suksesit të shoqërisë së pavarur të konsulencës të kontraktuar nga METE (pagesa e kësaj shoqërie përcaktohej edhe në VKM e cila miratoi dokumentacionin e tenderit që duhej të paguhej nga ofertuesi fitues,pra është paguar dy herë.

c) shpërblimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,të Komitetit të Konsulencës dhe Transparencës si edhe Grupit të Negocimit,sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave.

d) Trajtimin e punonjësve që do të dalin pa punë nga procesi i ristrukturimit të OSSH në kuadër të privatizimit te saj.

Ne kuadër të këtij privatizimi i u nxorrën pa punë minimalisht 1400 punonjës të cilët kurrë nuk e morrën këtë trajtim financiar të parashikuar me ligj, përkundrazi punonjësit e OSSH janë rropatur dyerve të gjykatave .

Përse nga ana e tij nuk u zbatua ky detyrim ligjor?

37.22 **Perse nuk e konsideroi te pasukseshme kete procedure dhe te konfiskonte garancine e ofertes duke tentuar mbase nje perseritje te saj?**

37.23 Në dt 01.07.2008 ai ka leshuar urdhrin nr. 500 "Për ndarjen e të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet KESH sha dhe OSSH si dhe marrëdhëniet tranzitore ndërmjet dy shoqërive".

Si mundej ai si ministër dhe person përgjegjës direkt për këtë proces privatizimi, të autorizonte hapjen e këtij procesi në qershor të vitit 2008 dhe ndërkohë në Korrik të vitit 2008 të nxirrte një urdhër të tillë pra, të autorizonte nisjen e procesit të privatizimit pa ndarë të drejtat dhe detyrimet ndërmjet KESH dhe OSSH?

37.24 Përse ai nuk e ushtroi të drejtën ligjore që ju jepte VKM nr. 487, dt 16.04.2008 në pikën 6 të saj ku ai si ministër i METE-s, me një urdhër te motivuar ligjesisht, kishte të drejtë në çdo rast të terhiqej nga procesi i shitjes apo ta ndërpriste atë.

37.25 A e ka njohur ai Nuel Kalaj? Kush e ka prezantuar me te? A eshte takuar me te dhe per cfare ka biseduar?

37.26 A e ka njohur ai Hamza Merxhanin? Kush e ka prezantuar me te? Po me te per cfare ka biseduar?

38. **Pyetjet qe nuk iu bene Sali Berishës**

38.01 **A ka qënë i bindur Sali Berisha se, ishin pjekur kushtet për privatizimin e OSSH-së në vitin 2008?**

Cfare e shtyhu Sali Berishen qe te hyje ne nje proces te tille?

Nga cili person apo institucion erdhi per here te pare kjo ide?

Si u iniciua ky proces?

(Banka Botërore dhe Komisioni European kanë konstatuar se ky proces ka qënë i nxituar)

Kseniya Lvovsky, drejtore e Bankës Botërore Tiranë, ka deklaruar ne Dhjetor të vitit 2012 se: ky proces ka qënë i nxituar pavarësisht se ne e kemi mbështetur një hap të tillë.

Në mbledhjen e qeverisë të datës 17.09.2008, zëvendësministri i Integritimit të asaj kohe, Albert Gajo, ka thënë se: shqetësimi i specialistëve të Komisionit European është se një ndërmarrje me bilanc negativ nuk mund të privatizohet.

38.02 **A ishte i bindur Sali Berisha se legjislacioni i kohës në të cilën u krye privatizimi i OSSH ishte i mjaftueshëm për këtë qëllim?**

Ne qofte se jo, përse nuk ndërmorri më parë plotësimin e kuadrit ligjor për këtë lloj privatizimi?

38.03 A duhej përdorur ndonjë procedurë tjetër për privatizimin e OSSH-se, p.sh ankandi?

38.04 Përse u nxitua ai për të hyrë në një proces të tillë privatizimi, pa zgjidhur problematikën e zgjidhjes së titujve të pronësisë, për asetet e OSSH-së, një pjesë e të cilave i përkasin edhe sot Kesh-it?

(Kështu në datën 14 Janar 2008, me ane të shkresës Nr. 393 prot , zv. Ministri i METE z. Neritan Alibali, i drejton një leter KESH-it dhe ERE-s, ku kërkon që të merren hapat e nevojshëm për realizimin e procedurave të vleresimit të aseteve. **(E. 6)**)

Në datën 9.5.2008, në mënyrë pak se një muaj përpara hapjes së procedurave për fazën e parë të tenderit, Ministri i METE-s z. Genc Ruli, me ane të Vendimit Nr. 4, autorizon fillimin e procedurave për transferimin e titujve të pronësive të OSSH nga KESH-i të METE. **(E. 7)**

Lidhur me këtë problematikë kemi edhe Urdherin Nr. 329, datë 9.5.2008 të METE-s **(E. 8)**

Po kështu kemi edhe Urdherin Nr. 329/1 datë 12.5.2008 firmosur nga z. Neritan Alibali drejtuar KESH-it lidhur me transferimin e titujve të pronësive. **(E. 9)**

Në datën 8 Korrik 2008, me ane të shkresës Nr. 6466, Ministri Genc Ruli i kerkoi Zyres Qendrore të Pasurive të Paluajtshme, përshtypimin e procedurave për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të OSSH. **(E. 10)**

Cështja e pronësive të pasurive të paluajtshme ndërmjet KESH-it dhe OSSH-se është përpjekur të zgjidhet me VKM Nr. 1108, datë 30 Korrik 2008 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në pronësi të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, sha". **(E. 15)** Edhe kjo VKM, përveçse ka dalë me shumë vonese dhe vetëm pak javë para hapjes së ofertave të Fazës së dytë të tenderit, nuk e ka zgjidhur këtë problem, pasi akoma edhe sot ka mjaft konflikte gjyqësore lidhur me pronësinë e subjekteve që kanë certificate pronësie për pronat që i kanë kaluar OSSH-se me këtë VKM).

38.05 Përse ai ka hyrë në këtë proces privatizimi pa zgjidhur marrëdhëniet dhe detyrimet ndërmjet Kesh-it dhe OSSH-së?

(Në datën 2 Shkurt 2008 me shkresën Nr. 1210, Ministri Ruli, kërkon mendim nga Z. Bode, midis të tjerave, për borxhin rreth 400 milion dollarë që i është krijuar KESH-it, për arsye të faturave të papaguara të energjisë elektrike. **(E. 12)** Në dokumentat e mëvonshme, nuk përmendet se si u trajtua kalimi i këtij borxhi dhe si e sa u arketua ky borxh nga CEZ-i gjatë menaxhimit të tij.

Me urdherin Nr. 2, datë 12 Shkurt 2008 të Komitetit të Konsulencës dhe Transparencës, Kryetar i të cilit ishte z. Genc Ruli, theksohet se, KESH-i duhet të raportojë për ecurinë e punës në lidhje me detyrimet e huave që do t'i kalojnë OSSH-se. **(E. 13)**

Me Urdherin Nr. 329, datë 11 Maj 2008 të Ministrit Ruli, kërkohet reflektimi i ndryshimeve në bilancin e shoqërisë KESH. **(E. 8)**

Në datën 1 Korrik 2008, z. Ruli ka nxjerrë Urdherin Nr. 500 "Për ndarjen e të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet KESH dhe OSSH si dhe marrëdhëniet tranzitore ndërmjet tyre". **(E. 14)**

Pra edhe pse kishte kaluar nje muaj nga hapja e procedurave te privatizimit, detyrimet ndermjet KESH-it dhe OSSH-se nuk ishin ndare akoma.

Pak vite me pas, ky Urdher eshte perdorur disa here nga drejtuesit cek, te CEZ Shperndarje, kunder qeverise shqiptare, si prove per mos shlyerjen e detyrimeve).

38.06 Përse ai ka ndërmarrë nje proces të tillë privatizimi pa u testuar më parë “Modeli i Ri i Tregut të Energjisë”?

(Pergjate zhvillimit te ketij procesi, Modeli i Tregut te Energjise Elektrike eshte ndryshuar disa here, gje qe eshte krejt e pazakonte, pasi jo vetem flet per nje mungese pergatitje nga ana e legjislacionit, por edhe per nje ndryshim te rregullave te lojes gjate procesit. Ky fakt provohet nga Vendimet e meposhtme te Keshillit te Ministrave :

- VKM Nr. 628, date 3 Tetor 2007 “ Per miratimin e Modelit te Tregut te Energjise Elektrike”; **(E. 16)**
- VKM Nr. 338, date 19 Mars 2008 “Per miratimin e Modelit te Tregut te Energjise Elektrike”. **(E. 17)**

Ne menyre te nxituar, eshte hyre ne privatizim pa u krijuar e testuar Modeli i Ri i Tregut dhe per me teper, pa vene ne dijeni ERE-n per detajet lidhur me kete privatizim. Ne letren Nr. 12/1, date 11.1.2008, Kryetari i ERE z.Bujar Nepravishta, kerkoi nje informacion te plote e me te detajuar lidhur me kete process privatizimi. Nga ceshtjet qe ai trajtoi ne kete leter, kuptohet se ERE nuk ka qene ne dijeni as per parametrat ligjore te ketij privatizimi, jo me per detajet. **(E. 11)**

(Mund te shtojme ketu edhe ndryshimin 4 here te Deklarates Rregullatore te Leshuar nga ERE).

38.07 Përse ai me anë të V.K.M 835 dt 11.06.2008 përcaktoi se: Madhësia e kapitalit të OSSH-së që do të privatizohej do të ishte 76%?

Cili ishte personi i pare qe e propozoi kete shifer?

Cili ishte qellimi i vendosjes se kesaj shifre?

- **Përse nuk eshte zbatuar ligjin 8306 dt 14.03.1988 “Për privatizimin e Sektorëve me rëndësi të veçantë”, i cili në nenin 10 të tij parashikon se: për mbrojtjen e interesave të tij, shteti mban në pronësi një paketë aksionesh ose “Aksionin e Artë”?**
- **A nuk e dinte ai se 76% te aksioneve do ti jepnin të drejtë CEZ-it, ose kujtdo fituesi tjetër qe do të vinte më pas, që në bazë të nenit 87 të ligjit 9901,dt 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” të vendoste me ¾ e votave te ortakëve ndryshimin e statusit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin e shoqërisë dhe prishjen e saj?**
- **Përse nuk eshte marrë parasysh këtë kërkesë ligjore?**
- **A mos fillimisht u miratua ligji “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe pastaj ai dhe qeveria e tij me V.K.M miratuan madhësinë e aksioneve që do të privatizoheshin, pikërisht duke patur parasysh këtë klauzolë ligjore?**

- **A mendonte ai se ky vendim i tij, për të privatizuar këtë madhësi aksionesh, i bëri të mundur stafit Cek te CEZ-shperndarje, që të realizonte të gjitha shkeljet e mundshme, per te cilat ju hoq licensa dhe palet u detyruan te shkojne ne Arbitrazh, duke krijuar kosto per Shtetin Shqiptar?**

(Baza ligjore mbi te cilen u krye privatizimi ishte Ligji Nr. 8306, date 14.03.1998 “Per privatizimin e sektoreve me rendesi te vecante”, i ndryshuar. **(E. 18)**)

Ky ligj parashikonte se kriteret e pergjithshme per privatizimin, kriteret e percaktimit te investitoreve strategjike, procedura e perzgjedhjes si dhe formula e privatizimit, percaktohet rast pas rasti nga Keshilli i Ministrave. Ligji parashikon ne nenin 10 te tij se, shteti, per mbrojtjen e interesave te tij publike dhe strategjike, mban ne pronesi nje pakete aksionesh ose “aksionin e arte”. Me ane te ketyre mekanizmave, shteti rezervon te drejten per te mbrojtur interesat e veta strategjike dhe publike. **(E. 18).**

Ne realitet, kjo porosi ligjore nuk eshte zbatuar ne kete rast, pasi me ane te VKM Nr. 835, date 11 Qershor 2008 “Për përcaktimin e madhësisë së paketës së aksioneve të kapitalit, të shoqërisë “OSSH”, që u ofrohet investitorëve strategjikë” **(E. 5)**, madhesia e kapitalit te OSSH-se qe u ofrohej investitoreve strategjike, ishte 76 %.

Duke miratuar kete pakete aksionesh, Keshilli i Ministrave nuk mori parasysh mbrojtjen e interesave strategjike te shtetit shqiptar.

Dhenia per privatizim e 76 % te aksioneve, i dha te drejte CEZ-it qe te zoteronte Asamblene e Pergjithshme te kompanise me mbi ¾ e votave. Pra vetem me 1 apo 2 % aksione me teper, qe u miratua me kete VKM, ju dha e drejta stafit drejtues te CEZ-it, qe te ndryshonte statutin, te shperndante fitimet, te riorganizonte shoqerine, bile edhe ta prishte ate. E gjitha kjo gjente mbeshtetje ne nenin 87 te Ligjit Nr. 9901, date 14.4.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, ligj ky i miratuar vetem disa muaj para kesaj VKM. **(E. 19)**

Eshte e papranueshme qe vetem per 1 apo 2 perqind te aksioneve, shteti shqiptar te mos arrije te mbroje interesat e tij te ligjshme ne kompanine ne te cilen ne te ardhmen do te ishte aksioneri minoritar. Realiteti tregoi se, stafi menaxherial cek, i beri te gjitha shkeljet e mundshme, ne menaxhimin e CEZ Shperndarje, pa patur asnje pengese apo rezistence ligjore nga aksioneri minoritar, qe ishte shtetit shqiptar, duke sjelle keshtu gjithe sistemin elektroenergjitik shqiptar, ne nje kolaps te plote dhe ne gjendje falimentimi).

38.08 Perse nuk jane respektuar afatet ligjore te procedures se tenderit te hapur nderkombetar?

Neni 11 i ligjit 8306 i vitit 14.03.1998 “Për Privatizimin e Sektorëve me Rëndësi të Veçantë” përcakton se:

- Për zbatimin e procedurave të privatizimit, që nga momenti i publikimit, duhet të respektohet një afat minimal tre mujor, me qëllim sigurimin e transparencës.
- **Përse ofertat parakualifikuese u hapën pa u respektuar ky afat?**

Privatizimi i OSSH-së u nis me miratimin e ligjit nr 9889 dt 20.03.2008 “Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të OSSH-së”, pra në më pak se tre muaj para hapjes së

ofertave parakualifikuese.

Përse nuk u respektua ky afat si detyrim ligjor?

(Neni 11 i Ligjit 8306, date 14.03.1998 “Per privatizimin e sektoreve me rendesi te vecante” percakton se per zbatimin e procedurave te privatizimit, qe nga momenti i publikimit duhet te respektohet nje afat minimal 3 mujor, me qellim sigurimin e transparences. **(E. 18)**)

Ne realitet, privatizimi i OSSH nisi me Ligjin Nr. 9889, date 20.03.2008 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të Shoqërisë anonime “OSSH”, **(E. 20)** ndersa ofertat per parakualifikimin dolen ne daten 2 Qershor 2008, pra ne me pak se 3 muaj nga sa ishte parashikuar ne afatin minimal ligjor).

A eshte favorizuar CEZ-Group nga mosrespektimi i ketij afati?

A kane pasur mundesi reale kompani te tjera te interesuara per te marre pjese ne kte privatizim qe te pergatiten ne nje kohe kaq te shkurter?

Si ka mundesi qe nuk ka rene ne sy te qeverise ky mosrespektim afatesh?

Cila eshte pergjegjesia e qeverise ne kete rast?

A ka pasur ndonje kerkese apo planifikim te qellimshem mosrespektimi i afateve?

38.09 Përse nuk u vendos një çmim dysheme për shitjen e aksioneve të OSSH-së?

Si gjithmonë në rastin e shitjeve zbatohen parimet e ankandit duke vendosur një çmim dysheme.

38.10 Përse nuk është mbajtur një protokoll për këtë procedurë privatizimi ose nëse është mbajtur përse nuk gjëndet një protokoll i tillë në Kryeministri, Ministri apo OSSH?

Kjo është një kërkesë ligjore të cilën e parashikon edhe ligji i Prokurimit Publik në nenin nr 42 pika 3 e tij.

38.11 Përse nuk është respektuar afati ligjor lidhur me dorëzimin e ofertave?

(Sipas ligjit të prokurimit ky afat ligjor duhej të ishte jo më pak se 52 ditë nga data në të cilën është bërë njoftimi i prokurimit. Njoftimi i prokurimit është bërë me dt 09.05.2008 me anë të vendimit nr 3 dt 09.05.2008 të Komitetit të Konsulencës dhe Transparencës, ndërsa procedura për parakualifikim ka filluar me 2 Qershor 2008, pra, vetëm pas 23 ditësh).

38.12 Përse nuk janë respektuar kërkesat ligjore lidhur me perberjen e Komisionin e Vlerësimit të Ofertave?

A ka ndikuar mënyra e krijimit të këtij Komisioni të Vlerësimit të Ofertave në mbarëvajtjen e mëtejshme të procedurave të privatizimit?

Cfare pergjegjesie ka pasur ai dhe qeveria e tij lidhur persa me siper?

Ne kreun 7-të pika 1 te V.K.M 329 dt 12.07.1999 “Për procedurat e tenderimit për zgjedhjen e investitoreve strategjikë”, përcaktohet se:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të jetë Komiteti i Konsulencës dhe Transparencës në përputhje me VKM 621 dt 25.09.1998, si edhe një përfaqësues i Agjencisë së Prokurimit Publik. Konstatohet se i gjithë komisioni në përbërjen e tij ka qënë në kundërshtim me të gjithë keto kërkesa ligjore. Kryetari i këtij komisioni duhej të ishte Genc Ruli, i cili ishte edhe kryetari i Komitetit të Konsulencës dhe Transparencës.

(Ne Kreun VII, pika 1 të VKM Nr. 329, datë 12.7.1999 "Per procedurat e tenderit per zgjedhjen e investitoreve strategjike dhe per transferimin e aksioneve te zoteruara nga shteti ne shoqerite tregtare te sektoreve me rendesi te vecante", (E. 40) percaktohet se :

"Komisioni i vleresimit te ofertave do te jete Komiteti i Konsulences dhe i Transparences, ne perputhje me vendimin e Keshillit te Ministrave nr.621, date 25.9.1998, si dhe nje perfaqesues i Agjencise Kombetare te Privatizimit (AKP).

Ne piken 3 te VKM Nr. 621, date 25.9.1998 "Per krijimin e komitetit te konsulences dhe te transparences per privatizimin e sektoreve me rendesi te vecante te ekonomise", (E. 41) percaktohet se :

"Komiteti përbëhet nga 13 anëtarë, dy përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, një përfaqësues nga Ministria e Financave, një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, dy përfaqësues nga organet përkatëse, që përgjigjen për administrimin e pronës shtetërore, të cilët kanë në vartësi dhe gjashtë anëtarë të tjerë, që do të caktohen ndërmjet konsulentëve financiarë, ligjor dhe të marketingut, të seleksionuar në nivel ndërkombëtar nëpërmjet procedurave konkurruese të njohura nga Banka Botërore".

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për privatizimin e OSSH i ngritur me Urdherin Nr 329, datë 13.05.2008 (E 42), ka patur në përbërjen e tij 5 përfaqësues të METE dhe 4 përfaqësues të IFC, kjo në kundërshtim të hapur me dy VKM-te e lartpërmendura (E. 40 dhe E. 41)

Duke qenë se z. Genc Ruli nuk e kishte deleguar detyrën e tij si Kryetar i Komitetit të Konsulencës dhe Transparencës, ai duhet të ishte Kryetar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Pikërisht mënyra joligjore e ngritjes së këtij Komisioni, ka ndikuar që në hapin e parë që ka bërë ky komision, i cili në të njëjtën ditë që është ngritur, ka miratuar Dokumentet e Tenderit për fazën parakualifikuese.(E. 43).

38.13 Përse u ngrit Komisionin e Vlerësimit të Ofertave edhe në kundërshtim me VKM nr 1 dt 10.01.2007 "Për Prokurimin Publik", pika 1a) dhe 2 ç)?

Aty thuhet se, duhet të sigurohet një ndarje e qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve të përfshirë në hartimin e dokumentave dhe atyre të përfshirë në përzgjedhjen e fituesve.

(Ngritja e këtij Komisioni dhe funksionimi i tij, bie në kundërshtim me VKM Nr. 1, datë 10 Janar 2007 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" (E 44) dhe konkretisht me pikat 1/a dhe 2/ç të saj.

Në keto pika parashikohet se duhet të sigurohet një ndarje e qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve të përfshirë në hartimin e dokumentave të tenderit dhe atyre të përfshirë në përzgjedhjen e fituesve. Pra kjo VKM percakton qartë se KVO është përgjegjëse vetëm për shqyrtimin e ofertave.

38.14 Përse u lejua të ndryshonte niveli i borxhit të keq nga 4 % në 14%?

A e dinte Sali berisha se, ky veprim kishte një kosto në dëm të buxhetit të shtetit rreth 70 milionë dollarë në vit?

A e dinte ai se nuk duhej të bëhej asnjë bisedë me perfaqësuesit e CEZ-Group lidhur me ndryshimin e ofertës apo dokumentat e tenderit pas paraqitjes së ofertës me dt 29.09.2008?

Përse e lejoi ai një gjë të tillë dhe e miratoi atë?

Kush ishte iniciuesi për t'a ndryshuar kete nivel te borxhit te keq?

Ku dhe si eshte debatuar dhe negociur ndryshimi i nivelit te borxhit te keq?

Pse nuk u vendos qe ne fillim ky nivel i borxhit te keq?

Si u lejua qe ky nivel i borxhit te keq, i parashikuar ne kushte e tenderit te ndryshohej pas hapjes se ofertave?

A ka pasur ndikim Sali Berisha tek vendimi i ERE-s për t'a ndryshuar kete nivel te borxhit te keq?

Në zbatim të ligjeve 8306 dt 14.03.1988 dhe 9889 dt 20.03.2008, qeveria Berisha ka nxjerrë dy VKM nr 487 dt 16.04.2008 dhe 835 dt 11.06.2008 lidhur me kriteret e përzgjedhjes së investitorëve strategjikë, si edhe me përcaktimin e madhësisë së aksioneve që do tju ofrohet investitorëve strategjikë. Me anë të këtyre VKM-ve, ajo ka përcaktuar disa kushte minimale sic është ai i borxhit të keq. Në keto VKM përcaktohet se Investitori Strategjik ka pasur të drejtë të trajtojë vetëm justifikimin e borxhit të keq, pra palët duhet të binin dakort se kush do të quhej borxhi i keq dhe jo të diskutonin në lidhje me nivelin e borxhit të keq, i cili ishte përcaktuar paraprakisht në Deklaratat Rregullatore të ERE-s në masën 4%.

38.15 Përse nuk është zbatuar nga qeveria Berisha, kërkesa ligjore e parashikuar nga vete VKM-ja e nxjerre prej saj Nr. 835 date 11.06.2008 se, palet duhet te nenshkruanin marreveshjen per blerëjn e aksioneve, brenda 30 diteve nga shpallja e fituesit?

Cila ka qene arsyeja qe nuk u respektua ky afat?

Perse nuk u konfiskua sigurimi i ofertes si mase e parashikuar nga ligji pikerisht per kete rast?

38.16 Përse u negociuan kushtet e Tenderit te miratuar me VKM, pasi CEZ u shpall fitues, bazuar në këto kushte?

Fjala eshte për procesin e negociimit, të zhvilluar pas datës 29.09.2008 datë në të cilën u bë dorëzimi i ofertave.

Cili eshte personi apo personat pergjegjes lidhur persa me siper?

Perse ka marre pjese ne nje nga mbledhjet e ketij komisioni keshilltarja e tij Suzana Guxholli?

Cfare roli kishte ajo dhe ke perfaqesonte ajo atje?

Cfare lidhje kishte ajo me kete proces?

Pse ajo ka marre pjese ne mbledhje pikerisht ne takimin kur u deklarua per here te pare nga ish ministri Ruli se vlera e aseteteve te OSSH-se ka rene dhe se nevojitet rivleresimi i tyre?

A ishte ajo atje si shenje e vullnetit te tij?

A ka ndikuar prania e saj ne bindjen e pjesmarresve ne kete mbledhje?

A ishte e ligjshme prania e saj ne ate mbledhje?

38.17 Me anë të VKM nr.218 dt 06.03.2009 :

a) Qeveria Berisha ka kaluar në favor të OSSH-së asetet e financuara nga KESH-i apo kredi afatgjata të marra nga këto kompani në vlerën prej 1.1 mld lekë.

b) Ka kaluar detyrimet e OSSH-së tek Kesh në vlerën 2.68 mld lekë dhe 2.3 mld lekë, investime të Bankës Botërore dhe Bankës Europiane të Investimeve.

c) Detyrimet afatshkurtra për blerjen dhe transmetimin e Energjisë që OSSH i kishte Kesh-it në vlerën 1 mld lekë u shuan.

d) Shuma prej 0,53 mld lekë që i korespondon pagimit të huave afatgjata në vitin 2008 nga KESH-i u vendos të pasqyrohej si rritje kapitali për OSSH-në.

Pra, vetëm me anë të një VKM të nxjerrë më 6 mars të vitit 2009 kjo qeveri favorizoi CEZ-in me 7.61 mld lekë apo me kursin e atëhershëm 76 mln dollarë.

Cfarë ka për të thënë lidhur me kete VKM, Sali Berisha?

A mendon ai se keshtu do te duhej te trajtohej klauzola Purchase Price Adjustment?

Përse ishin zhvlerësuar sipas tij asetet e OSSH-së?

38.18 Perse detyrimet e OSSH-se i kalojne KESH-it, dhe ndryshohet edhe vete qendrimi i qeverise shqiptare te shprehur nepermjet z.Ruli me shkresen Nr. 180 te dates 9 Janar 2008 "Komente ne lidhje me Due Diligence dhe opsionet strategjike per privatizimin e shperndarjes se KESH Sh.A" qe z. Genc Ruli i ka derguar z. Angelo Dell'Atti, perfaqesues i IFC ne Tirane, shprehet se: "ne piken 1.a. se, detyrimet qe lidhen me kredite, huate te marra nga KESH-i per investime ne asetet e OSSH-se ne momentin e privatizimit, nuk jane realisht detyrimet e KESH-it, pasi asetet qe do te privatizohen, nuk jane pjese e aseteteve te KESH-it dhe per me teper, kjo vlere eshte arketuar nga Qeveria?(E. 25).

Me tej Z. Ruli shprehet ne kete shkrese se :” Ne momentin qe keto investime finalizohen dhe kthehen ne asetete te OSSH-se, duhet te behet transferimi i tyre tek OSSH, duke bere edhe veprimet perkatese ne lidhje me keto asetete” dhe me tej “.... Duhet te bihet dakord qe pjesa e detyrimeve qe lidhen me investimet ne process, te kaloje si detyrim i OSSH-se”.

Nderson takimin e perbashket ndermjet Komisionit te Konsulences dhe Transparences dhe Komisionit te Negocimit per privatizimin e OSSH-se te mbajtur ne daten 26 Shkurt 2009 (E. 47),

ne prani edhe te Keshilltares se Kryeministrit zj. Suzana Guxholli, z. Ruli i ben te ditur pjesemarrsve ne takim, se gjate negociatave te fundit, kane dale disa probleme ne lidhje me vleren neto te aseteve (NAV) te OSSH-se.

Duke shqyrtuar procesverbalet e takimeve per negociatat mes paleve, qe fillojne qe nga datat 18 dhe 19 Nentor 2008 (E. 26), duke vazhduar ne datat 24 Nentor 2008 (E. 27), 4 Dhjetor 2008 (E. 28), 10 Dhjetor 2008 (E. 29), 11 Dhjetor 2008 (E. 30), 7 Janar 2009 (E. 31) dhe 8 Janar 2009 (E. 32), nuk rezulton te jete ngritur apo diskutuar nje problem i tille nga palet.

Per kete arsye, ngrihet pyetja: Ne cfare takimesh negociatore kane dale dhe jane ngritur keto probleme qe ngre ishministri Ruli?

Cili eshte roli i Sali Berishes lidhur persa me siper? Cfare debate ka patur ne qeveri, nese ka patur pergjate procesit te miratimit te kesaj VKM-je?

Z. Ruli ka parashtruar se ky zhvleresim eshte bere per shkak se, cmimi i blerjes eshte perlllogaritur mbi bilancin e vitit 2007, i cili rezulton i ndryshem nga Bilanci i vitit 2008, me nje renie te vleres se aseteve. Pikerisht per te mos ulur cmimin e blerjes, meqenese perfaqeson nje simbolike politike sipas z. Ruli, rruga me e mire do te ishte sjellja e vleres se aseteve ne vleren qe i referohet cmimit te blerjes.

Eshte e cuditshme qe z. Ruli i referohet Bilancit te vitit 2008, ne shkurt te vitit 2008, ne nje kohe qe zyrtarisht, Bilanci i vitit 2008 eshte miratuar nga Asambleja e Aksionereve te CEZ Shperndarje vetem ne daten 18 Qershor 2010. (E. 33).

Po ne kete takim, perfaqesuesi i IFC z. Tomas Sipos, shpjegoi hollesisht se ndryshimi negativ i vleres se aseteve, ka ardhur si pasoje e humbjeve operationale te shkaktuara nga adoptimi i cmimit per blerjen e energjise nga OSSH prej KESH-it.

Nga ballafaqimi i bilanceve te OSSH-se per vitet 2007, 2008, 2008 i riparaqitur, dhe 2009, rezulton qe jo vetem nuk kemi ulje te vleres neto te aseteve, por kemi rritje te tyre.

Lidhur me kete pretendim, duhet te theksojme se cdo investitor strategjik e ka ditur mjaft mire se me privatizimin e OSSH-se, do te fillonte edhe aplikimi i Modelit te Tregut te Energjise Elektrike. (E. 17).

Pavaresisht se OSSH ishte e patestuar me Modelin e Ri te Tregut, (gje qe do te thote perseri qe ky privatizim ishte i nxituar), perseri jemi te mendimit se CEZ-i, si te gjithë investoret e tjere strategjike, kishte mundesi te llogariste mjaft mire oferten e bere, ne baze te tarifave te vendosura nga ERE me Vendimin Nr. 75, date 26.06.2008, i cili i shtrinte efektet e tij nga data 1 Janar 2008 deri ne 28 Shkurt 2009. (E. 48).

Cmimi i percaktuar nga ERE ne kete vendim ka qene 1.61 leke/kwh dhe ishte nje cmim i cili favorizonte OSSH-ne dhe disfavorizonte KESH-in, ne nje kohe qe cmimi i importit te energjise per kete periudhe ishte mesatarisht 8 leke/kwh.

Ne mbledhjen e Keshillit te Ministrave te dates 17 Shtator 2009, pak perpara hapjes se ofertave, eshte diskutuar edhe problemi i ketij cmimi. Ketu del se cmimi i vendosur nga ERE ishte i afert me koston te cilen KESH-i e prodhonte, por shume i ulet po ta krahasosh me cmimin me te cilin KESH-i e blente nga importi.

Krahasimi bilanceve të vitit 2007 dhe 2008 flet për një shëndoshje të kompanisë OSSH.

Tabelë përmbledhëse për Bilancet e viteve 2007,2008,2008 i rivlerësuar dhe 2009

Përshkrimi	Bilanci 2007	Bilanci 2008	Bilanci 2008 i rivlerësuar	Bilanci 2009
Aktivet Fikse	16,319,822.00	17,399,956.00	29,421,486.00	27,869,329.00
Llogaritë e arkëtueshme		6,753,070.00	10,672,074.00	10,672,074.00
Aktivet Qarkulluese	2,916,369.00	6,644,884.00	3,854,053.00	1,337,216.00
Aktive të tjera -		2,917,135.00	96,752.00	
Totali i Aktiveve	25,989,261.00	34,716,914.00	46,864,748.00	35,668,412.00
Detyrimet Afatshkurtra	1,814,955.00	10,175,765.00	8,883,102.00	16,486,612.00
Detyrimet Afatgjata	16,118,377.00	11,346,962.00	11,601,761.00	11,135,152.00
Totali i detyrimeve	17,933,332.00	21,522,727.00	20,484,863.00	27,621,764.00
Vlera neto e Aseteve=Kapitalin Aksionar	8,055,929.00	13,194,187.00	26,379,885.00	8,046,648.00

1.Viti 2007 është mbyllur me një vlerë neto të asetëve: 8.055,929 mijë .Kjo vlerë sipas marrëveshjes së shitjes do të merret si reference për rishikimin e çmimit.

2.Në vitin 2008 janë rritur aktivet me 8,727 miliardë leke.Kjo ka ardhur si rezultat i rritjes së llogarive të arkëtueshme nga klientët dhe nga Keshi.Duke qene se për vitin 2008 Aktivet janë rritur me shume se Pasivet apo detyrimet, për rrjedhojë kemi një rritje të Kapitalit Aksionar .

3.Ne vitin 2009 Shoqëria ka bërë një rivlerësim të Bilancit të 2008-es me pretendimin se pasqyrat duhet të përpilohen në përputhje me Standartet Nderkombetare.Si pasojë e këtij rivlerësimi në bilanc kemi këto ndryshime:

3.1 Aktivet Fikse janë rritur ndjeshëm me përafërsi 12 miliardë leke.(Kolona e katërt në tabelë ,rreshti i parë).

3.2 Rritja e Aktiveve Fikse ka sjellë rritjen e Kapitalit Aksionar dhe në të njëjtën kohë ka pakësuar humbjen e akumuluar nga vitet e mëparshme.Kjo ndodh sepse humbja është pjesë e kapitalit aksionar.Duke u rritur ky i fundit humbja zvogëlohet.

3.3 Si rezultat e rritjes së Aktiveve fikse janë rritur edhe Asetet Neto të Shoqërisë nga 13 miliardë në vitin 2008 (kolona e tretë rreshti i fundit në tabelë) në 26 miliardë (kolona e katërt, rreshti i fundit në tabelë).

Në mbyllje të vitit 2009 Shoqëria ka bërë rivlerësimin e bilancit të vitit 2008 kjo me qëllim që Pasqyrat Fianciare te ishin të hartuara në bazë të Standarteve Ndërkombëtare. Si pasojë e këtij rivlerësimi kemi një rritje të ndjeshme të Aktiveve Fikse me përafërsi 12 miliardë lekë. Si pasojë e kësaj rritjeje njëkohësisht është rritur edhe Kapitali Aksionar duke zvogëluar në këtë mënyrë humbjen e akumuluar të viteve pasi humbjet janë pjesë e Kapitalit Aksionar. Si pasojë e këtij Rivlerësimi, Asetet Neto të shoqërisë janë rritur me 13 miliardë lekë.

38.19 Përse ky problem u ngrit vetëm në 26.02.2009 nga këshilltarja juaj Suzana Guxholli në mbledhjen e përbashkët të Komitetit të Konsulencës dhe Transparencës dhe Komisionit të Negocimit?

Perse ajo u be pjese e ketij procesi?

A fliste ajo ne emrin e Sali Berishesj?

A percillte ajo qarte mesazhin se kjo ishte deshira dhe vullneti i Sali Berishes?

38.20 Bazuar në kreun 4 pika a) të VKM nr 329 dt 12.07.1999, ofertuesi duhet të paraqesë një garanci financiare në favor të METE-S në vlerën 20% te vlerës së aksioneve të ofruar në tender. Bazuar në urdhrin nr 319 dt 06.05.2008 te ministrit Ruli (për zmadhimin e kapitalit te OSSH) kjo garanci bankare duhej të ishte minimalisht në vlerën prej 40 mln dollarëve. Kjo garanci oferte do të konfiskohej në rast se CEZ do të dështonte të nënshkruante brenda 30 diteve kalendarike pas njoftimit te fituesit marrëveshjen e blerjes së aksioneve kryesisht në formën e paraqitur në ofertën e tij.

Me dt 13.08.2008 ju keni nxjerrë nje VKM nr 1170 me anë të të cilit vendosni se garancia e ofertës për këtë procedurë privatizmi do te jetë 5 mln euro.

Perse u vendos per nje garanci oferte nje shifer te tille minimale?

Përse qeveria Berisha nuk e konfiskoi garancinë e ofertës, pasi kaloi afati 30 ditor pas njoftimit të fituesit dhe marrëveshja nuk ishte nënshkruar nga CEZ?

38.21 Neni 3 i ligjit nr 9889 dt 20.03.2008 “Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit te shoqërisë OSSH”parashikohet se :

Pjesa e mbetur e aksioneve të OSSH 24% duhejt të ofrohej :

a) ish subjekteve të shpronësuar të truallit dhe të ndërtesave .

b) punonjësve të OSSH-së në shkëmbim të aksioneve me bonot e privatizimit apo letrave me vlerë.

c) të persekutuarve .

Deri më sot nuk kemi gjetur asnjë lloj akti ligjor apo nënligjor i cili mund të faktojë zbatimin e këtij detyrimi ligjor.

Përse ka ndodhur kjo?

Cili eshte personi pergjegjes per moszbatimin e ketij parashikimi ligjor?

Ku vajten ato te ardhura dhe si u justifikua perdorimi i tyre ne kundershitim me kete parashikim ligjor?

A perben ky rast nje mashtrim te paster publik, kur punonjesit dhe popullata qetesohet dhe bie dakort per kete privatizim sepse mendojne se do te jene pikerisht ata perfituesit?

38.21 Neni 3 i ligjit nr 9889 dt 20.03.2008 "Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë OSSH"parashikon se :

-Të ardhurat nga privatizimi(Shuma prej 102 mln Euro) do të përdreshin për:

a) Mbulimin e shpenzimeve për organizimin e procedurave të tenderit dhe për veprimtari të tjera që i nevojiteshin procesit të privatizimit.

b) Pagesën e tarifës së suksesit të shoqërisë së pavarur të konsulencës të kontraktuar nga METE(pagesa e kësaj shoqërie përcaktohej edhe në VKM e cila miratoi dokumentacionin e tenderit që duhej të paguhej nga ofertuesi fitues,pra është paguar dy herë.

c) shpërblimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,të Komitetit të Konsulencës dhe Transparencës si edhe Grupit të Negocimit,sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave.

d) Trajtimin e punonjësve që do të dalin pa punë nga procesi i ristrukturimit të OSSH në kuadër të privatizimit te saj.

Ne kuadër të këtij privatizimi i u nxorrën pa punë minimalisht 1400 punonjës të cilët kurrë nuk e morrën këtë trajtim financiar të parashikuar me ligj,përkundrazi punonjësit e OSSH janë rropatur djerve të gjykatave .

Përse nga ana e Qeverise Berisha ky parashikim ligjor?

Cili eshte personi pergjegjes persa me siper?

38.22 **Perse nuk e konsideroi te pasukesshme kete procedure dhe te konfiskonte garancine e ofertes duke tenduar mbase nje perseritje te saj?**

38.23 **A e njeh Sali Berisha Nuel Kalajn?**

A eshte takuar ndonjehere me te?

Nese po, sa here dhe ku?

Cfare kane biseduar se bashku?

Cfare i lidh ata te dy?

Ku dhe si jane njohur?

Cila eshte lidhja e tyre?

Cili person i ka prezantuar?

A keni folur ndonjehere me te ne telefon?

A kane folur se bashku ne telefon ne vjeshten e vitit 2005-6?

A ka lobuar Nuel Kalaj, prane tij, ne vitin 2006, per privatizimin e OSSH-se ne favor te CEZ-it?

Nese po, kur ka qene biseda e pare lidhur persa me siper?

A ka qene ne dijeni Sali Berisha se Nuel Kalaj ka pasur nje shperblim te premtuar nga CEZ-Group lidhur me suksesin e ketij privatizimi?

A ka qene ne dijeni Sali Berisha se Fatos Nano e kishte refuzuar me pare kerkesen e CEZ-Group per privatizimin e shperndarjes se energjise elektrike?

Cilat ishin arsyet e Nanos te nje refuzimi te tille?

A ka qene i pranishem fizikisht Nuel Kalaj pergjate periudhes 2005-2013 neper institucionet e Shtetit shqiptar?

A ka nderhyre ai ne marredheniet CEZ-Shperndarje-ERE, ne favor te CEZ-it?

A ka qene ne dijeni te axhendes se Sali Berishes, Nuel Kalaj dhe nese po, si ka qene e mundur kjo gje?

A ka organizuar ai takime midis Sali Berishes dhe drejtuesve te CEZ-Shperndarje?

A e ka deleguar Sali Berisha ate te flase me ministrin Ruli lidhur me privatizimin e OSSH ne vitin 2006?

A ka qene ne dijeni te transaksioneve te parave CEZ-Nuel Kalaj?

Cili person e ka ndihmuar Nuel Kalajn qe te terhiqte shuma te pajustificuara parash nga banka?

Cili ishte personi qe e ka ndihmuar Nuel Kalajn qe te nxirrte ne menyre te jashteligjshme shuma te medha parash nga vendi?

A ka marre para apo premtime per para Sali Berisha nga Nuel Kalaj?

Nese po, kur jane marre ato pra dhe sa ka qene shuma e tyre?

A e ka rekomanduar Sali Berisha, Nuel Kalajn si nje person influent tek ERE? Si e shpjegon Sali Berisha faktin qe, drejtuesit e CEZ-it keshilloheshin me Nuel Kalajn perpara ne lidhje me EREN?

Nuel Kalaj, ne fillim te vitit 2017 u tregua i gatshem qe te vinte per te deshmuar perpara komisionit hetimor parlamentar. Si e shpjegon Sali Berisha terheqjen e tij?

A ka dijeni Sali Berisha per ndonje telefonate paralajmeruese apo kercenuese qe i eshte bere Nuel Kalajt pikerisht nje dite perpara se ai te nisej per ne Tirane?

A ka ndonje ndikim Sali Berisha ne dhenien e shtetesise shqiptare Nuel Kalajt?

Perse ruhej Nuel Kalaj nga police te forcave special dhe kush ia siguronte ate ruajtje?

A i ka dhene ndonje garanci Sali Berisha, Nuel Kalajt qe ndaj tij nuk do te kete asnje pasoje nga ky proces?

A e ka njohur Sali Berisha, Hamza Merxhanin?

A eshte takuar me te?

Nese po, ku dhe kur eshte takuar me te?

A ka pasur persona te tjere ne takim dhe cilet ishin ata?

Cila apo cilat kane qene tema e bisedes se kryer ndermjet tyre?

A eshte takuar ai me Nuel Kalajn dhe Genc Rulin ne vitin 2006?

Kapitulli V

39. Konstatime

Konstatohet qarte se:

- 39.01 Vendimi i Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, Dhoma Penale, per pushimin e kesaj ceshtjeje nuk eshte ne zbatim te ligjit, se eshte i pambeshtur ne prova dhe argumenta dhe shpreh qarte se, gjykata vendosi lidhur me pushimin e kesaj ceshtjeje, pa realizuar ne seancen paraprake as minimumin e perpjekjeve per te zbuluar faktet dhe provat, per te realizuar nje proces te plote

hetimi, per te hyre ashtu sic duhet ne thelbin e ceshtjes, por toleroi per nje periudhe dy vjecare nje inaktivitet te plote te Prokurorise se Tiranes;

- nuk jane pyetur fare personat e perfshire ne kete proces privatizimi;
- se nuk eshte bere ne menyre te pabesueshme as edhe nje konstatim i shkeljeve te ligjeve dhe akteve nenligjore pergjate te gjithë kesaj procedure prokurimi;
- se eshte shkelur me te duja kembet ligji lidhur me afatet;
- se eshte shkelur ligji ne lidhje me ngritjen e komisioneve;
- se ne kunderseshtim me ligjin eshte bere ndryshimi i ofertave dhe dokumentave te tenderit pas hapjes se ofertave;
- se nuk eshte lidhur kontrata 30 dite pas njoftimit te fituesit ashtu sic e parashikon edhe ligji;
- se u favorizua ne kundershtim me ligjin pergjate rivlerisimit te asetëve pala ceke me 70 milione USD,;
- se ndryshimi i paligjshem i nivelit te borxhit te keq penalizoi buxhetine shtetit shqiptar me 70 milione USD;
- se kompania konsulente IFC eshte paguar ne kundershtim me ligjin dy here;
- se nuk eshte bere konfiskimi i sigurimit te ofertes dhe anulimi i procedures ashtu sic e parashikon ligji;
- se sigurimi i ofertes u aplikua jo ne masen qe parashikonte ligji;
- se te gjitha keto veprime jane bere duke u bazuar ne balance te pamiratuara zyrtasisht;
- se argumentimi se asetet e OSSH-se ishin te zhvlesuara nuk qendron sepse ato realisht kishin pasur investime te tjera shtese;
- se shkeljet ligjore jane te nje sasive te paimagjinueshme lidhur me kete procedure;
- se kjo procedure realisht ka filluar ne vitin 2005 me ane te nje ndermjetesesi i cili eshte paguar per kete ndermjetesim;
- se demi financiar i shkaktuar nga keto veprime amtiligjore nuk mund te mohohet nga askush;
- se cdo veprim i Qeverise Shqiptare te asaj kohe, duke filluar nga ndarja e KESH-it, miratimi i Modelit te Ri te Tregut, miratimi i Kodit Tragtar etj, jane bere me emergjence vetem me qellimin per te privatizuar OSSH-ne nga pala ceke dhe brenda mandatit te pare qeverises te PD-se ne periudhen 2005-2009;
- se gjykata deshtoi ne kete gjykim;
- se ajo nuk pranoi as moskopmetencen per vete rastin e vecante dhe cilesine e personave te kallezuar;

- se percaktimi juridik i veprave penale u be qellimisht i padrejte duke u fokusuar vete tek ndikimi i paligjshem dhe pastrimi i produkteve te veprave penale, duke mos dashur, qe te konsideroje abuzimin dhe shperdorimin me detyren, prishjen e barazise neper tendera, korrupsionin etj;
- se gjykata ka deshtuar qe te binde se vendimi i saj eshte teresisht i mbeshtetur ne fakte e prova;
- se gjykata i injoroi lidhjet shkak-pasoje te cilesuar nga une dhe lehtesisht te verifikueshme;
- se ka deshtuar qe faktet e nxjerra nga ne t'i pajiste me provat e duhura;
- se kemi nje mosrespektim nga ana e saj te nje sere klauzolash te KPrP si psh nenet 28/3, 72, 73, 74, 75/a,ç, 83, 84, 149, 150, 151, 152, 153, 154, 328, 329 etj.

I nderuar Zoti Kraja,

Ne perfundim te parashtrimit te ankeses sime, une kerkoj qe, nga ana juaj, te verifikohet ne menyre te hollesishme procesi i privatizimit te OSSH-se si dhe procedura me numer 7340/2017 se bashku me vendimin numer 5410/211 i dates 24.01.2020, ora 15:33 dhe date rregjistrimi 10.12.2019.

Problemet kryesore te konstatuara nga une pergjate ketij procesi jane:

1. **Prokuroria dhe gjykata kane deshtuar qe te bejne nje hetim te plote dhe te gjejne prova ne mbeshtetje te fakteve te konstatuara nga une, duke mos analizuar te gjitha momentet e kallezimit tim dhe duke mos pyetur te gjithe personat e kallezuar si dhe te tjere qe kane lidhje dhe kane dijeni per kete afere.**
2. **Prokuroria nuk ka verifikuar destinacionin perfundimtar te parave, te cilat Nuel Kalaj i ka marre ne menyre te pajustificueshme nga banka, veprim te cilin e ka konstatuar edhe komisioni hetimor parlamentar dhe qe vete Nuel Kalaj e ka pranuar publikisht.**
3. **Prokuroria nuk ka pyetur pothuaj te gjithe personat e perfshire zyrtarisht ne kete afere.**
4. **Prokuroria dhe gjykata nuk kane dashur qe te konkludojne se: a ka patur apo jo dem ekonomik pergjate ketij procesi privatizimi, cilat jane arsyet e ketij demi ekonomik dhe personat pergjegjes.**
5. **Prokuroria ka bere qellimisht nje cilesim te gabuar juridik te veprave penale duke shmangur veprat e shperdorimit te detyres si dhe ate te korrupsionit dhe gjykata e ka pranuar ate;**
6. **Gjykata dhe prokuroria nuk kane dashur qe te konstatojne shkeljet e shumta ligjore, te cilat nuk kane nevojte te provohen dhe qe jane te pakundershtueshme. Ne lidhje me keto shkelje, ceshtja eshte teresisht e zbardhur ne menyre te pakundershtueshme, personat pergjegjes gjithashtu si dhe demi i percaktuar. Lidhur me kete aspekt te kesaj ceshtjeje, kjo dosje eshte plotesisht e gatshme per t'u cuar ne gjykate.**
7. **Prokuroria dhe gjykata ne shkelje te KPrP nuk kane bere asnjehere njoftim per zhvillimin e seancave pergjate kohes se gjate te zhvillimit te ketij procesi;**
9. **Prokuroria dhe gjykata e zvarriten kete proces, duke iu dhene kohe te mjaftueshme te kallezuarve, qe te merrnin masat e tyre, per prishjen e integritetit te ketij procesi;**

10. OSSH-ja nuk eshte shitur 102 milion euro sa pretendohet zyrtarisht, por shume me pak ose me sakte i eshte falur pales ceke, sepse ajo qe ne momentin e pare eshte favorizuar me mbi 110 milione euro. Prokuroria dhe gjykata nuk kane dashur te konstatojne demin ekonomik qe i eshte shkaktuar vendit nga realizimi i kesaj procedure. As nuk eshte marre fare ne konsiderate prej tyre ky aspekt. Fakti qe ato nuk kane dashur t'a konstatojne dicka te tille, nuk do te thote se ky dem nuk ekziston.
11. Ne kete ceshtje une konstatoj se, ka edhe vepra te tjera penale, te cilat prokuroria dhe gjykata nuk kane dashur qe t'i konstatojne. Kam dyshimet e mi ate arsyeshe se kemi te bejm eedhe me vepren penale te vjedhjes nepermjet mashtrimit, duke perdorur si mjet certifikimin e bilanceve te rreme per te ndikuar ne ujen e cmimit te energjise nga KESH-I tek CEZ-Shperndarje nepermjet vendimeve te ERE-s.
12. Gjykatesi ne vendimin e marre prej tij, nuk ka mbajtur asnje qendrim lidhur me shkeljet e shumta qe une kam evidentuar, gje qe eshte jashte cdo parametri dhe etike vendimi.

Ai do te duhej qe, per secilen nga ceshtjet e ngritura nga une, te ofronte nje analize te qendrimit tim dhe te prokurorise, si dhe me pas te argumentonte ligjerisht dhe me fakte qendrimin e tij.
I gjithë vendimi i tij eshte i privuar nga nje qendrim i tille dhe per rrjedhoje edhe nga faktet, provat dhe ligjshmeria.

Me respekt

Av. Romeo Kara

Ekspert Ligjor i OSHEE

e-mail: romeo.kara@oshee.al

e-mail: romeo.kara@yahoo.co.uk

tel: 00355 696128707

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndertesha 88, hyrja 1

Njesia administrative nr. 7 1023 Tirane